



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 30 korrik 2020, në mbledhjen e XXXIV (tridhjetë e katër) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;15 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve në ish ndërtesën e Komunës.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës,(Lista e nënshkrimeve).

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin edhe Drejtorët e Drejtorive (DSHMS, DBPZHR, DKA, DA, DKRS), përfaqësues të mediave dhe rrjetit të OJQ-ve DFK dhe OJQ-së SDK.

Rendi i Ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroi mirëseardhje në këtë seancë e cila gjithashtu po mbahet në kushte dhe masa jo të zakonshme për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19. Shtoi, konsideroj se thirrjen dhe materialet i keni marrë me kohë, po ashtu edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së e mbajtur një ditë më parë ku sigurisht keni mund të shihni se janë rekomanduar edhe 2 pika shtesë për këtë seancë, përkatësisht,

- *Informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, rreth gjendjes së krijuar nga coronavirusi Covid-19 në territorin e Komunës së Podujevës*
- *Propozimi i Drejtorisë së Arsimit, për ngritjen e Komisionit për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësrejtoreve në institucionet edukativo arsimore në Komunën e Podujevës*

Andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën.

z.Adnan Zymeri, theksoi, Lidhja Demokratike e Kosovës më datë 26.07.2020 ka humbur një njeri të madh, njërin prej themeluesve të LDK-së në Podujevë Hazir Raçi i cili përveç që ka qenë njeri i madh dhe i cili ka kontribuar për çështjen kombëtare ka qenë edhe Kryesues i Kuvendit të Komunës, andaj meqë ka pasur atë pozitë unë konsideroj se është e nevojshme që me 1 minutë heshtje ta nderojmë jetën dhe veprën e Tij që ka bërë për Komunën e Podujevës në veçanti dhe për Kosovën në përgjithësi.

z.Bajram Ajeti, theksoi, e përshëndes idenë e këshilltarit parafolës. Kam qenë nxënës i tani më të ndjerit Hazir Raçi dhe në kohën e Tij para LDK-iste e kam njohur më mirë, mirëpo një gjë ta them, e kam ndier vetën shumë keq kur ai njeri që ka qenë Kryesues i Kuvendit, dhe kur ai njeri ka qenë një anëtarë i LDK ashtu siç e potencoj këshilltari parafolës, është turp dhe duhet ta ndieni vetën keq që askush prej kësaj Komune nuk ishte në gjendje që me rastin e varrimit të Tij, ta thotë një fjalë lamtumirëse. Unë jam gjithsesi që ta nderojmë me 1 minutë heshtje.

Kryesuesi i Kuvendit, shtoi, pa dyshim që unë si Kryesues i Kuvendit tani mund të deklarohej se për një veprimtar, aktivistë, një pedagog, mësues dhe profesor dhe gjitha atributet tjera që kishte Hazir Raçi (tani i ndjerë) gjithsesi se duhet të mbajtur 1 minutë heshtje në nderim të jetës dhe veprës së Tij.

Mbahet 1 minutë heshtje në nderim të jetës dhe veprës së Hazir Raçi, tash më i ndjerë.

Kryesuesi i Kuvendit, në vazhdim theksoi, nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni nëse jo e vë në votim rendin e propozuar të ditës duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së ku përfshihen edhe dy pikat shtesë.

Pas votimit, njëzëri miratohet rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara së bashku me pikat shtesë nga mbledhja e KPF-së, dhe atë;

- ***Informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, rreth gjendjes së krijuar nga coronavirusi Covid-19 në territorin e Komunës së Podujevës***
- ***Propozimi i Drejtorisë së Arsimit, për ngritjen e Komisionit për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësrektorëve në institucionet edukativo arsimore në Komunën e Podujevës***

1. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për përfundimin e vitit mësimor 2019/2020

z.Agim Blakçori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit – DKA, e paraqiti informatën në fjalë, ndër të tjera shtoi, në funksion të përgatitjes për vitin shkollor 2019/2020 janë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të krijuar kushte për mbarrëvajtjen e procesit mësimor. Shikuar në përgjithësi periudha e parë e këtij viti shkollor por edhe periudha e dytë pothuajse deri në përfundim ka vijuar sipas planifikimeve mirëpo kur kemi parasysh situatën në të cilën gjendeshim në atë kohë dhe bazuar në vendimin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, shpallja e pandemisë nga Covid-19, Qeveria e Republikës së Kosovës më 11 mars 2020 merr vendim nr.01/7 sipas të cilit në pikën 1.1, citoj, *ndërprerja e mësimit edukativo arsimor në institucionet arsimore publike dhe private në të gjitha nivelet deri më 27 mars 2020*, pra fjala është për vendimin e parë me të cilin ndërpritet procesi mësimor dhe sipas e kësaj gjendje u shfaq nevoja për të gjetur alternativa tjera për vazhdimin e mësimit dhe me këtë rast Ministria e Arsimit, që është për tu përshëndetur, nuk qëndroj duarkryq por menjëherë mori iniciativën që mundësoj dhe gjeti forma për mësimin alternativ, mësimi në distancë dhe mësimin online.

Bazuar në raportet e rregullta që kanë dërguar drejtorët e shkollave vërehet se ka pas një mobilizim të mirë të të gjithë akterëve për realizimin e mësimit në distancë me një pjesëmarrje të konsiderueshme të nxënësve në këtë proces, por megjithatë në këtë proces të mësimit në distancë që ishte një risi në sistemin e arsimit në Republikën e Kosovës janë hasur edhe vështirësi dhe sfida të ndryshme me të cilat jemi ballafaquar të gjithë ne, duke marrë parasysh edhe gjendjen sociale dhe ekonomike të shumë familjeve tona por edhe përgatitjen e përdorimit të teknologjisë edhe të një pjese të mësimdhënësve, të gjitha këto kanë qenë sfida por megjithatë me një mobilizim çfarë ka qenë kemi arritur t'ia dalim kësaj sate. Pra për ta përballuar më lehtë situatën e krijuar nga pandemia Covid-19 Drejtoria e Arsimit ka bashkëpunuar ngushtë dhe ka qenë në kontakt të rregullt me Ministrinë e Arsimit si dhe në bashkëpunim me drejtorët e shkollave ju ka përmbajtur dhe ka zbatuar të gjitha vendimet, udhëzimet dhe rekomandimet nga institucionet relevante të Republikës së Kosovës.

Siç e ceka edhe më herët Ministria e Arsimit me të marrë vendimin për ndërprerjen e mësimin gjeti alternativa dhe filloi me regjistrimin e video-materialeve të cilat pastaj filloj t'i transmetoi në Televizionin Publik të Kosovës-RTK, dhe në platforma të ndryshme të internetit, pra me datë 23 mars 2020 veç filluan me plasimin e këtyre video-materialeve dhe kjo vazhdoj më pastaj fillimisht me nxënësit e nivelit 1-fillor, mandej me nivelin 2-arsimi i mesëm i ulët, dhe më pastaj edhe me nivelin 3-arsimi i mesëm i lartë. Në bazë të vendimeve të Ministrisë së Arsimit organizimi i mësimin për nxënësit e kl. I-rë deri në IX-të ka qenë në formë të centralizuar ku materialet janë përgatitur nga Ministria e Arsimit dhe janë transmetuar në Televizion dhe platforma të ndryshme të internetit, kurse tek arsimi i mesëm i lartë ka qenë në formë të decentralizuar ku vetë mësimdhënësit, drejtoritë e shkollave në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Arsimit kanë arritur të gjejnë forma për të mbajtur mësimin online dhe mësimin në distancë. Më pastaj është përgatitur edhe platforma për edukimin parashkollor përkatësisht fëmijët e kësaj moshe të cilët nuk kanë mbetur anash edhe kjo kategori.

E ceka edhe më herët që Vendimi i Ministrisë së Arsimit apo më saktësisht vendimi i Qeverisë, e ndërprejnë mësimin për një kohë të caktuar duke pas parasysh rrethanat në të cilat gjendeshim nuk e dinim se si do të zhvillohen ngjarjet, për atë arsye mësimi ndërpritet fillimisht vetëm deri më 27 mars 2020, mirëpo rrethanat e diktuan që ky proces të vazhdoj edhe më tutje dhe të gjejmë forma.

Në funksion të përfundimit të vitit mësimor 2019/2020, Ministria e Arsimit ka miratuar një varg të dokumenteve të cilat i keni të llastuara në Informatën e dërguar, dokumente të cilat na kanë bërë të mundeshe që të gjitha ato dilemat dhe vështirësitë që kishim gjatë procesit mësimor, sepse pikëpyetje që u ngritnin e dinë më së miri mësimdhënësit dhe i gjithë komuniteti arsimor, se si do të vie deri te përfundimi i notave, dhe si do të bëhet vlerësimi, pra të gjitha këto i kishim pikëpyetje ne, mirëpo megjithatë Ministria e Arsimit me kohë ka nxjerrë edhe udhëzimet edhe rekomandimet edhe vendimet e duhura e që kemi arritur ta përfundojmë këtë vit shkollor i cili do të mbahet mend për një kohë të gjatë për hir të rrethanave në të cilat është zhvilluar.

Viti mësimor 2019/2020, sipas kalendarit të përshtatur nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë thuhet që përfundimi i vitit mësimor për kl. e XII-të bëhet me 20 maj 2020, për kl. IX-të, X-të, dhe XI-të viti përfundon më 12 qershor 2020, kurse për kl. I-rë deri në VIII-rë dhe për parafillorët viti mësimor përfundon më 26 qershor 2020.

Nga ky vit mësimor, ju njoftoj se Drejtoria e arsimit ka bërë të gjitha përgatitjet për të mbajtur tastin e arritshmërisë dhe testin e maturës, por si pasojë e rrethanave të krijuara nga kjo pandemi, Ministri i Ministrisë së Arsimit merr vendim me të cilin shtyhen datat e për mbajtjen e dy testeve të cekura, ku testi i arritshmërisë do të mbahet më 20 gusht 2020, ndërsa testi i maturës do të mbahet më 29 gusht 2020, pra kjo gjithmonë sipas vendimit të Ministrit.

Pa dashur të zgjasë më shumë po e ndjejë të nevojshme të shfrytëzoj rastin të falënderoj të gjithë mësimdhënësit e Komunës së Podujevës për punën dhe përkushtimin e tyre për organizimin e mësimin në distancë të cilin edhe përkundër sfidave dhe vështirësive me të cilat ballafaqoheshin arritën ta kryejnë detyrën të cilën ua ka besuar shoqëria dhe këtë detyrë e kanë kryer çdo herë me përgjegjësi të lartë.

znj. Arlinda Kadriu, theksoi, arsimimi dhe edukimi i brezava të rinj dihet se është një mision në vete dhe vazhdimisht vazhdoj ta mbështes idenë që vetëm të flasësh për këtë çështje është përgjegjësi e lëre më të punosh në këtë drejtim.

Fillimisht është për tu përshëndetur sjellja me kohë e informatës nga Drejtoria e Arsimit lidhur me mbarëvajtjen e vitit mësimor përkatës. Ashtu siç cekë edhe në informatë, viti shkollor 2019/2020 ka filluar mbarë dhe perioda e parë është kryer me sukses ashtu edhe siç është planifikuar, mirëpo pas shpalljes së pandemisë kemi hasë në vështirësi gjatë periodës së dytë dhe të tretë të këtij viti shkollor dhe duhet theksuar se ka vazhduar në një mënyrë aspak të zakonit, do të thotë ka qenë një sfidë në

vete duke përfshirë Ministrinë, Drejtorinë komunale, mësimdhënësit, nxënësit dhe të gjithë akterët tjerë që janë përfshirë në këtë proces.

Pa dashur të përsërisë, siç edhe është theksuar edhe në informatën në fjalë, mësimi në distancë ka filluar me kohë në Komunën e Podujevës, gjë për të cilën duhet falënderuar Drejtorinë e Arsimit e cila me kohë ka bërë përcjelljen e informatave lidhur me vendimet që janë marrë nga Ministria e Arsimit. Ky proces ka qenë një sfidë për të gjithë, posaçërisht për neve që kemi qenë të kyçur direkt në këtë proces, vështirësi të cilat kanë qenë në shumë sfera duke përfshirë mungesën e teknologjisë, pastaj mungesën e njohurive në përdorimin e platformave të ndryshme, mungesën e njohurive lidhur me vlerësimin që do të bëhet, edhe pse të gjitha kanë ardhë me kohë prapëseprap vështirësitë i shohin vetëm ata që janë të kyçur direkt në procesin mësimor.

Nga këtu edhe njëherë dëshiroj t'i falënderoj të gjithë mësimdhënësit të cilët edhe njëherë e dëshmuar se pa marrë parasysh pengesat që iu dalin, me çdo kusht tentojnë ta kryejnë me sukses detyrën që iu është dhënë atyre. Njëkohësisht i falënderoj edhe prindërit edhe nxënësit që kanë bërë një punë të shkëlqyeshme në këtë drejtim. Gjithmonë ka vend për përmirësime, për vërejtje dhe kritika, mirëpo në përgjithësi ka ecur mbarë.

Shpresoj shumë që viti i ri shkollorë do të filloj mirë dhe në rregull, që pandemia të përfundoj dhe t'i kthehemi normalitetit, mirëpo në qoftë se nuk ndodh një gjë e tillë me mësim në distancë, kam dy pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, dhe atë;

1-a keni ndonjë informacion se a do të mbahet ndonjë trajnim online për mësimdhënësit lidhur me mësimin në distancë, platformat që do të përdoren dhe mënyrën e vlerësimit, sepse ne njëherë e mbaruam një punë të ngjashme mirëpo t'ju them të drejtën ka qenë shumë e lehtë për arsye se e kemi kryer një periudë e gjysmë dhe kemi pasë përafërsisht një vlerësim për nxënësit, ndërsa në qoftë se një vit shkollor fillon nga fillimi me mësim në distancë atëherë do të jetë shumë më e vështirë të përfundoi si duhet në këtë mënyrë, andaj do të ishte shumë e lehtë nëse ofrohet një trajnim online për mësimdhënësit. Në qoftë se nuk ka Drejtoria e Arsimit një informatë të tillë dhe ne pse nuk ka ndonjë nismë të tillë nga Ministria e Arsimit, kërkoj nga drejtori i DKA-së që të paraqet një kërkesë të tillë në adresë të Ministrisë së Arsimit lidhur me këtë çështje.

2-edhe pse nuk lidhet direkt me pandeminë, por ka ndërlidhje me pandeminë, fjala është me tekstet shkollore e që nga këtu njëherë kam kërkuar që a ka ndonjë mundësi që të bëhet më tepër presion që të dalin tekstet e reja shkollore, në fakt ato kanë dalë për shumicën e lëndëve, mirëpo me keqardhje e them sepse është një gjë shumë e rëndësishme dhe që nuk duhet anashkaluar ngase në ato tekste shkollore shumica e nxënësve kanë vërejtur shumë gabime duke përfshirë këtu edhe gabime të tipit profesional, mandej shumë shpesh janë promovuar edhe dukuri negative siç është ajo e bullizmit me dije apo pa dije nga autorët, gjë për të cilat unë personalisht kam shkuar në Ministrinë e Arsimit dhe kam kërkuar përgjigje se a është mundur të bëhet një korrigjim i këtyre teksteve, por që përgjigja e tyre ka qenë se pas realizmit të një pyetësi nëpër shkollë lidhur me vlerësimin që do ta bëjnë mësimdhënësit lidhur me tekstet shkollore, do të bëhet korrigjimi i këtyre teksteve shkollore, andaj kam vetëm një pyetje, çfarë kuptimi ka marrja e informatave dhe njohurive nëpër tekstet shkollore kur ato gjysma prej tyre janë të gabuara, do të thotë është pothuajse baras me zero, si dhe pyetja ime për drejtorin e DKA-së është se a ka ardhë ndonjë pyetësorë dhe a është shpërndarë nëpër shkollë lidhur me vlerësimin që duhet të japin mësimdhënësit lidhur me tekstet shkollore, nëse jo serish do të kërkoja që të ndërmerret një iniciativë e tillë në mënyrë që të korrigjohen këto tekste shkollore sepse pa marrë parasysh mënyrën se si do të realizohet mësimi, njohuritë sërish do të merren nga këto tekste.

Për fund, që të dalim të suksesshëm duhet që të jemi shumë të përpiktë në punën që bëjmë nga secili prej nesh, të mos provojmë të gjejmë asnjëherë fajtorë për dështimet e fëmijëve tanë, mirëpo ta

kryejmë punën të gjithë ashtu si duhet, por posaçërisht ky trekëndëshi i suksesit që unë e konsideroj kështu që është bashkëpunimi mësimdhënës-prindër-fëmijë, e pastaj nëse kemi diçka për tu ankuar normal që duhet të ankohemi sepse unë gjithmonë vazhdoj ta mbështes idenë që për të qenë të suksesshëm duhet të jemi gjithmonë kritik dhe autokritik në këtë drejtim, posaçërisht kur flasim për edukimin e brezave të rinj.

z.Avni Fetahu, theksoi, Informata për arsim e sjellë këtu para nesh, më shumë i ngjanë një kronologjie të disa detyrave dhe përgjegjësi që ka Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Drejtoria e Arsimit se sa që përmban ndonjë element të informatës për çka ne edhe jemi mbledhur sot këtu mbase edhe qytetarëve dhe neve si këshilltar komunal na intereson se sa ka qenë pjesëmarrja e nxënësve në mësimin online me shifra dhe përqindje, sa prej tyre janë që nuk e kanë ndjekur mësimin si rezultat i mungesës së pajisjeve të nevojshme, çka ka bërë Komuna për këtë kategori ndonjëse një informatë për tu quajtur si e tillë, do të duhej t'i ofronte të paktën këto dhëna, por si do që të jetë, gjendja e arsimit në Komunën e Podujevës ka kohë që është në gjendje jo të mirë dhe e dallueshme shumë nga komunat tjera si në investime kapitale, në inventar, në kabinete e shumë forma të tjera prej momentin kur Ministrinë e Arsimit e kanë udhëheq ish Kryetari por edhe Nënkryetari pasi që kanë qenë pjesë përbërëse e saj, për të vazhduar me vonë edhe me udhëheqjen e Arsimit edhe në Komunën e Podujevës ku prioritet i tyre kanë qenë tenderët dhe punësimet klienteliste të tyre duke lënë anash politikat zhvillimore të arsimit, e me këtë edhe dështimin në shume projekte me interes për nxënësit tanë.

Karakteristikë e udhëheqjes së Drejtorisë së Arsimit prej që udhëheq ish Kryetari me të ka qenë vendosja e drejtorëve 100% të dëgjueshëm ku në një formë ose tjetër ata vetëm formalisht kanë qenë aty pasi që me Drejtorinë në fjalë ka udhëheq ai vet, sidomos tek tenderët dhe punësimet klienteliste, ndërsa disa ekskursione brenda dhe jashtë vendit ua ka lënë edhe Nexhit (Nënkryetarit të Komunës) nga pak me qëllim për të njollosen të gjithë nga pak.

Duke ju rikujtuar ju të ndërtuar këshilltar komunal dhe ju qytetarë të respektuar se për dallim nga Drejtoritë e tjera n'kuadër të Komunës, Drejtoria e Arsimit e ka buxhetin e ndarë nga granti specifik i arsimit, ka zyrtarin e saj për financa dhe si e tillë kjo ka mundë të funksionoj shumë mirë, por atë nuk e lënë grupet e ndryshme të interesit dhe ata të Ekzekutivit duke punësuar njerëz të afërm të tyre dhe duke anashkaluar edhe persona me master të fushës se njëjtë. Në anën tjetër Organizata joqeveritare “Demokracia Fillon Këtu”, ka reaguar për mos dhënien e informatave nga Drejtoria e Arsimit në Podujevë, për mësimin e ndjekur online në kohë pandemie, duke shkruar edhe me tutje Organizata ne fjalë thotë se këto pajisje sipas të dhënave të tyre asnjëherë nuk janë shpërndarë tek nxënësit në nevojë, andaj dëshirojmë të dimë nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit a ka përgjigjeje lidhur me këtë çështje të ngritur.

Lëvizja Vetëvendosje, në vazhdimësi ka kërkuar trajtimin me dinjitet të sektorit të arsimit përmes ndarjes së buxhetit për arsim e me këtë edhe investime në Arsim, në biblioteka, kabinete të nevojshme për nxënës e në ambiente atraktive për nxënës, por për kundër kësaj sot kemi shkolla pa kabinete funksionale, nuk kemi teknologjinë e nevojshme për të zhvilluar mësim në distancë, bibliotekat kanë mbetur nën mëshirën e ndonjë njeriu vullnet mirë që ofron tituj librash, ato kabinete në numër të vogël që janë, kanë mbetur nën mëshirën e ndonjë vullneti të mirë që i rregullon ato pajisje të stërvjetuara tani më ku sistemi operativ nëpër ata pak kompjuterë ose është 2003 ose nuk ekziston fare.

Drejtorët e shkollave kur pyeten thonë se në vazhdimësi ata bëjnë kërkesa, por ato kërkesa kthehet zakonisht në fund vitit me ndonjë paketë me domestos të kontraktuara natyrisht nga “tuxhari” i tenderëve, dhe kështu përfundon një vit shkollorë sa i përket investimeve nëpër shkolla. Shpeshherë e kam pyet veten, more a kane fëmijë këta dhe a mendojnë të paktën për fëmijët e tyre që investimi

në arsim është edhe investim për të ardhmen e fëmijëve të tyre, e shpejt e kam gjetë përgjigjen pasi që një numër i madh i tyre, fëmijët dhe nipat e tyre i shkollojnë jashtë komunës me të cilën udhëheqin, pra thjesht janë shndërruar në administrator si në kohën e UNMIK-ut, e Komunën e kanë shndërruar në një bankomat ku vetëm i marrin rrogat dhe i kurdisin tenderët. Për ta pasur të qartë se nga po shkon gjendja e arsimit në Komunën tonë duhet pasur një plan zhvillimor të arsimit, e që ky plan i mungon Komunës tonë, të paktën në ueb faqe nuk është i publikuar, e që sa për dijeninë e juaj deri më tani komunat me plane zhvillimore të arsimit janë: Prishtina, Mitrovica, Ferizaj, Prizreni, Peja, Gjakova, Gjiçani, Suhareka, madje edhe Dragashit i ka ardhë rend ta hartoj një plan të tillë, ku përmes këtij plani zhvillimor përshkruhen sfidat në sektorin e arsimit në komunë dhe objektivat strategjike për tejkalimin e sfidave dhe kështu do të sigurohej një baraspeshë më e mirë midis nevojave zhvillimore të shkollës dhe prioritetëve lokale, e nuk do të kishim drejtime të njëjta sidomos në shkolla profesionale siç ndodhë rëndom që 15 vite me drejtime të njëjta. Edhe pse korniza ligjore u siguron shkollave autonomi në lidhje me financat, shkollat ende nuk e menaxhojnë buxhetin, DKA menaxhon drejtpërsëdrejti kodet buxhetore duke detyruar kështu shkollat që të kalojnë nëpër Komunë edhe për riparimet më të vogla të mundshme.

Lëvizja Vetëvendosje, ju propozon të ndërmerrni hapat e nevojshëm për përgatitjen e vitit të ri shkollore duke bërë; -Identifikimin e nxënësve që kanë nevojë për tablet për mësimin nga distanca, -Sigurimin e tabletëve për nxënësit, -Sigurimin e pajisjeve të nevojshme në kabinetet e shkollave, -Shndërrimin i së paku një klase në secilën shkollë në kabinet ku secili mësues mësues shfrytëzon mundësimin e zhvillimit të mësimin nga distanca, -Sigurimin e internetit në të gjitha shkollat e Komunës, si dhe -Transparencën dhe llogaridhënien për procesin e mësimin nga distanca.

z.Pajtim Hodolli, theksoi, fillimisht e ftoj drejtorin e Drejtorisë së Arsimit të marr shënime sepse në muajin dhjetor 2019 kur pata folë, pata bërë shumë pyetje por nuk më është përgjigjur.

Ne dëgjuam drejtorin e DKA-së i cili na tregoj rreth asaj çfarë ka punuar Ministria e Arsimit dhe çfarë vendimesh ka marrë ajo për ta zbatuar mësimin nga distanca, e që e falënderojmë për këtë mirëpo këto të dhëna ne i dimë sepse janë publike dhe mund t'i marrim edhe në ueb faqe të MASHT-ti por edhe nëpër vende të tjera, mirëpo ajo që mua më intereson është se çfarë keni bërë ju për ta zbatuar në praktikë këtë metodë të re të mësimin nga distanca.

Ne nuk dëgjuam asgjë konkrete nga ju se cilat janë sfidat dhe ku i keni hasur ato, a keni staf të përgatitur për t'i edukuar fëmijët tanë me trendin e kohës për vitin 2020, që ende një pjesë nuk dinë ta përdorin teknologjinë informative, sa përqind e nxënësve ju kanë përgjigjur mësimin online, a kanë bashkëpunuar prindërit, a kanë pasur pajisje nxënësit, a ku qëndron problemi konkret.

Ju nuk dhatë asnjë të dhënë për shkollat, si kanë performuar dhe sa është shkalla e suksesit në përqindje pasi në bazë të të dhënave statistikore ne mund të dimë se sa keq ka dështuar kjo metodë e të aplikuarit të mësimin online. Unë kam pasur kontakte me shumë mësues mësues dhe prindër të cilët kanë treguar se shkalla e suksesit është minimale, arsimtarët nuk kanë pasur një metodë të qartë dhe unike të komunikimit me nxënësit, disa nga ata kanë komunikuar nëpërmes rrjeteve sociale mirëpo nuk kanë komunikuar fare. Qasja juaj nuk mu duk shumë serioze, çka është edhe më keq, në përfundim të vitit keni kërkuar nga arsimtarët që të rriten shifrat e suksesit për pjesëmarrje vetëm të dilet mirë me statistika pa qarë kokën se a kanë mësuar fëmijët diçka apo jo, kjo është edhe e kundërligjshme.

(Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, ndërhyrë nga vendi i cili ndër të tjera thotë, nëse vetëm një fakt e gjeni, unë që tani jap dorëheqje).

Nëse unë do t'i përmendja me emra ata kolegë do të vepronit njëjtë sikurse që keni vepruar, shembull, mësues mësuesen Zhitija që vie nga subjekti jonë PDK e cila sot e asaj dite nuk është më në marrëdhënie pune.

Sipas disa mësimdhënësve, vlerësimi nëpër shkolla është bërë në shumicën e rasteve paushallë dhe pa u bazuar në performancën e nxënësve, pra janë notuar njëjtë si nxënësit aktiv dhe si ata që kanë dërguar detyrat me rregull.

Kemi të dhëna se keni pranuar donacion pajisje në emër të nxënësve dhe asnjëherë nuk i keni shpërndarë, kjo është keqpërdorim nëse ka ndodhur, prandaj për ta qartësuar këtë unë kam disa pyetje konkrete që jua drejtoj juve si drejtor i Drejtorisë së Arsimit, dhe atë:

-A keni pranuar donacion me pajisje elektronike, si lloptop ose pajisje tjera, a ju kanë dhuruar nxënësve apo janë mbajtur për shfrytëzim të disa mësimdhënësve.

-Sa është pjesëmarrja aktive e nxënësve në mësim, sipas përqindjes dhe sipas lëndëve të ndara në shkollat fillore.

-Sa është pjesëmarrja aktive e nxënësve në mësim sipas, përqindjes dhe sipas lëndëve të ndara në shkollat e mesme.

-Duke ditur gjendjen e rëndë ekonomike të komunitetit RAE në Podujevë dhe pjesëmarrjen e ulët të shkollimit të tyre, sa është pjesëmarrja aktive e këtyre nxënësve të Komunitetit në Komunën tonë.

-A ka raste të raportuara nga nxënësit që nuk kanë pajisje elektronike, si kompjuter-telefon-tablet, dhe si pasojë e tyre nuk mund të qasen në mësimin në distancë.

-A ka ndihmuar Komuna e Podujevës ndonjë nxënës me pajisje elektronike për të ndihmuar qasjen në mësimin në distancë, nëse po sa nxënës janë ndihmuar.

-Pyetje tjetër, tashmë dihet situata që e kem, mirëpo edhe shtatori do të filloj me probleme të njëjta sa i përket mësimin në distancë dhe ai do të zhvillohet njëjtë, pra në distancë. Çfarë keni ndërmarrë që t'i sanoni problemet e paraqitura deri më tani të mos paraqiten edhe në të ardhmen.

-Tani kemi gjeneratën e maturantëve që dalin nga Podujeva e që do të ballafaqohen me konkurrencën në nivel vendi, pra me komunat e tjera. Çfarë keni bërë ju në këtë kohë të pandemisë që këta nxënës të jenë konkurrent me moshatarët e tyre nga Komunat e tjera.

z.Patriot Rudari, theksoi, kam një pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, ka të bëjë me atë se nëpër disa rrjete sociale ka qarkulluar një lajm kinse disa mësimdhënës kanë marrë disa lloptop për vete prej shkollave, e që do të thotë se nuk jua kanë dhënë nxënësve të cilët kanë pasë nevojë.

Pra është një çështje të cilën e kam parë edhe vetë në rrjete sociale dhe për të cilën edhe një ditë më parë bisedova me këshilltaren znj.Arlinda Kadriu për disa çështje rreth Gjimnazit “Aleksandër Xhuvani”, dhe për një gjë të tillë nuk dëshiroj të besoj se është e vërtetë, mirëpo po dëshiroj përgjigje edhe nga drejtori i DKA-së.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, dëgjova parafolësit, por edhe drejtorin e DKA-së me të cilin edhe në mbledhjen e KPF-së kemi diskutuar rreth gjendjes në arsim, me theks përfundimin e vitit shkollor 2019/2020 që ka qenë një vit dhe situatë sfiduese dhe formë e jashtëzakonshme e zhvillimit të mësimin si për mësimdhënësit, nxënësit por edhe për prindërit dhe jo vetëm për Kosovën por edhe për rajonin për të mos thënë në tërësi në botë.

Drejtori i DKA-së është e vërtetë se është personi kompetent në nivel lokal për arsimin e ultë dhe të mesëm sa i përket formës strikte të zhvillimit të arsimit, rekrutimit të personelit, menaxhimit të shkollave, përzgjedhjes së drejtorëve të shkollave të cilët pastaj janë kompetent të menaxhojnë me shkollat përkatëse. Po ashtu dëgjova edhe këshilltarin z.Avni Fetahu i cili vie nga fusha e arsimit dhe është duke punuar si profesor ashtu siç dëgjova e parafolësit tjerë si profesoreshën znj.Arlinda Kadriu. Është për tu përsëndetur sjellja e informatës nga DKA, por duhet ta kuptojmë se ky është një obligim dhe mendoj se si Kuvend nuk jemi që të marrim fjalën dhe vetëm të përsëndesim njëri tjetrin apo ndokënd por është obligim sjellja e informatës kur një gjë e tillë kërkohet, pastaj të përsëndetet që ka deleguar kompetencat te drejtorët e shkollave e që janë obligative nga Ministria e Arsimit, po ashtu është obligim zyrtar i drejtorit të DKA-së e jo për tu përsëndetur.

Sa i përket pengesave të nxënësve apo të familjeve që nuk kanë pasë qasje në arsim, në kyçje online, me mungesë të llogarëve apo të telefonave smart, edhe pse i takoj opozitës në këtë Kuvend, nuk e ngarkoj “thesin” drejtorit të DKA-së pse një pjesë e familjarëve në nivel Komune nuk i kanë këto kushte, mirëpo mendoj se si drejtor i DKA-së ishte dashur që sot në këtë informatë të sjellë informata strikte nga fusha e arsimit dhe të del në foltore dhe të thotë që secilit nga ju çka do që i intereson, qoftë edhe për një shkollë specifike unë jam i gatshëm të raportoj këtu dhe të jap llogari sa i përket menaxhimit, formës, mësimdhënësve që janë përzgjedh nga ju, drejtorëve të shkollave që janë përzgjedhë po nga ju. Unë jam në dijeni se problemet e arsimit nuk ju takojnë vetëm juve drejtor, por ka qenë një vazhdë për të cilën më së shumti kam trumbetuar dhe kam folë në këtë foltore të Kuvendit për problemet e arsimit, pra janë probleme që barten prej periudhës së ish drejtorit z.Avni Maloku, andaj edhe nuk po dëshiroj t’ju ngarkoj krejt juve, format e rekrutimit, përzgjedhjes, jo pavarësinë buxhetore të shkollave, centralizimet, madje është e vërtetë se ka pas profesor që nuk kanë ditë të punojnë me teknologjinë që ka dal e re për mësimin online e që pikërisht kjo është që të merremi me drejtorin e DKA-së sepse në qoftë se ju keni zgjedhë një drejtor shkolle të asaj kategorie, por pse një fëmijë ose një familje nuk ka kushte për tu kyçur duhet të thoni ju si drejtor se në NN shkollën ka munguar kjo përqindje e nxënësve për arsye të teknologjisë, kaq ka qenë buxheti i Drejtorisë, kaq janë ndihmuar shkollat, sepse në këtë situatë është e vërtetë se janë shpërndarë edhe ndihma dhe mjete buxhetore, dhe keni edhe zyrtarin për arsim, madje në vazhdim ne do ta votojmë edhe një komision për përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave dhe nëse ai komision të përzgjedh kuadro të tilla, atëherë me ju drejtor kemi punë sepse duhet respektuar dhe duhet t’i tregohen strikt format e rregullimit të konkursit se si zgjedhën.

Mandej centralizimi i buxheti ju takon juve drejtor, nëse e keni gjete ashtu nga drejtori paraprak ju është dashtë ta rregulloni në vitin 2020 në mënyrë që pastaj të dilni dhe të thoni se me mua drejtor të DKA-së është bërë ky ndryshim, mirëpo keni vazhduar formën e njëjtë të menaxhimit, centralizimit, përzgjedhjes së stafit, kam dyshime se do të vazhdoj sërish me këtë përzgjedhje të drejtorëve, madje unë vërejta se vetëm në këtë konkursin e fundit mbi 10 drejtor të shkollave të cilët pensionimin e kanë edhe 1 vit kanë konkurruar, mirëpo nëse e zgjedh vetëm një prej tyre e që mandati është 4 vjeçar, atëherë gjithçka po merret si politike dhe po shikohet nga syri opozitar se po gjykojmë apo që vetëm po trumbetojmë politikisht e që nuk është ashtu, kështu që përzgjedhja e drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe stafit është pjesë adekuate dhe personale e menaxhimit tuaj si drejtor i DKA-së. Sa na përket neve si opozitë, nuk kemi mundur me asnjë formë ta ndihmojmë dhe as nuk kemi pas ndonjë kërkesë sepse nuk jemi pjesë e asnjë organi i cili mund ta rregulloj këtë fushë, as e komisioneve përzgjedhëse e të tjera, mirëpo kemi dhënë kontributin tonë përmes kërkesave për raportime, informata aty ku kemi pas lajmërime se ka pengesa sepse edhe tek ne lajmërohen pengesat, kështu që për pyetjet e shtruara nga unë, nga kolegët z.Pajtim Hodolli dhe z.Avni Fetahu, është mirë të na jepni përgjigje, shembull, përse ndodh centralizimi i buxhetit dhe a kanë pavarësi financiare shkollat, sa përqind e nxënësve kanë munguar në mësimin online, cilat zona kanë qenë më të prekura nga kjo çështje, cili është (feedback) i drejtorëve tuaj që kanë sjellë këto pengesa.

Ne gjithë jemi në dijeni se mësimi ka përfunduar, pastaj nuk na intereson shumë nota mesatare e nxënësve sepse edhe kur është zhvilluar normal mësimi nota mesatare ka qenë rreth 2.3.

z.Agim Blakçori, drejtor i DKA, theksoi, unë jo rastësisht e përmenda që kjo gjendje ka qenë një sfidë për të gjithë neve, por kemi bërë përpjekje maksimale që të gjithë në bazë të përgjegjësive që kemi t’i kryejmë detyrat tona brenda mundësive tona dhe brenda këtyre rrethanave.

U ngritën edhe çështje të cilat ndoshta nuk kanë të bëjnë direkt me këtë temë por megjithatë do të mundohem që t’i përmbledh disa nga ato çështje që u ngritën. Shqetësimi më i madh i imi si drejtor i DKA-së dhe i gjithë komunitetit të arsimit është, çka nëse nuk fillojmë me mësimin e rregullt në

shkolla në muajin shtator të këtij viti, atëherë do t'i kemi telashet e mëdha. Sa i përket periudhës që e tejkaluam e që unë mendoj se e kemi tejkaluar me sukses sepse mbi 70% është ndjekë mësimi i rregullt nëpër shkolla kështu që një rreth 30% (madje për maturantët më pak se 30%) është ndjekë në format alternative. Nga kontaktet që kemi pas me mësime dhe me prindër e që ka pas edhe ankesa përse po ngarkohen nxënësit e që ndoshta edhe ky ka qenë problem si ngarkim i tepërt por megjithatë ka pas efekte pozitive kjo formë e organizimit të mësimit edhe në aspektin psikologjik edhe në aspektin pedagogjik por edhe në aspektin e përgjithshëm dhe unë për atë arsye e potencova se e përshëndes Ministrinë e Arsimit për këtë hap, pa e ditur se sa do të zgjasë ndërmori hapa dhe jemi aty ku jemi. Tani me vendimin e fundit të Qeverisë së Republikës së Kosovës i është kërkuar Ministrisë së Arsimit që brenda dy jave të bëjë planin se si do të veprojmë, dhe jemi në pritje që të kontaktojnë Ministria e Arsimit dhe do të kemi bashkëpunim të ngushtë me të në mënyrë që të gjejmë një formë më të mirë të mundshme për t'iu ofruar arsim nxënësve.

Sfida do të kemi, edhe mësime dhe që janë në moshë të shtyrë dhe që kanë vështirësi në përdorimin e teknologjisë, por mos mendoni se është lehtë edhe për vetë ata sepse kanë bërë një moshë dhe nuk kanë mundur të avancohen sa duhet në aspektin teknologjik, andaj çfarë të bëjmë me ata, por megjithatë janë angazhuar.

Jo vetëm sa për të thënë, në fund të paraqitjes së informatës unë i falënderova të gjithë mësime dhe drejtorët e shkollave. Këtu ka edhe këshilltarë që janë nga fusha e arsimit, para se të merr vendim MASHT, shumë mësime inovator kanë gjetur dhe kanë komunikuar me nxënësit e tyre, qoftë në nivelin fillor qoftë në atë të mesëm dhe vërtetë është për tu vlerësuar kjo.

Unë po e them se gjithçka ka qenë mirë sepse ka qenë sfidë dhe të gjithë kemi mësuar nga ky proces dhe kjo rrethanë, madje kemi marrë mësime të mirë që në të ardhmen ta përdorim këtë formë edhe gjatë kohës së rregullt të mësimit.

Sa i përket teksteve shkollore, kjo çështje është e Ministrisë së Arsimit të cilët vazhdimisht deklarojnë se kanë komisionet përkatëse dhe është çështje e Ministrisë kurse atë që e kanë kërkuar prej neve ne iu kemi ofruar, kemi ngritë si çështje se ka vërejtje prej mësime dhe prej nxënësve, kurse a do t'i marrin parasysh në ribotimin e teksteve nuk mund të jap përgjigje.

Gjendjen e arsimit në Komunën e Podujevës unë nuk do ta cilësoja se është më keq se në Komunat tjera dhe që të rinjtë tanë nuk janë konkurrent me të rinjtë e komunave tjera, këtë e kanë dëshmuar edhe sukseset e nxënësve tanë. Madje nganjëherë po interpelohet si gjendje e rëndë, ju them me përgjegjësi shumë të plotë se për shumë çështje rreth obligimeve dhe përgjegjësi të Drejtorisë së Arsimit, vetëm një shembull, rastësisht kam vërejtur një postim të një mësime në njërin prej fshatrave më të thellë në Llap i cili e ka fotografuar orarin, dhe aty janë lista e mësimeve të cilët mbajnë mësime ku kualifikimi i tyre, shumica prej tyre janë me master, me këtë dua të them se kur është në pyetje kadri mësime mund të them se kemi punuar shumë dhe sot edhe në fshatin më të thellë të komunës së Podujevës kemi staf të kualifikuar sipas normativit të cilin e kërkon Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

Ndoshta si lëshim më është përvjedhur dhe nuk kamë falënderuar kompaninë “Elkos” e cila ka dhënë një donacion prej 25 lloptopëve, sikurse që ju ka dhënë edhe komunave tjera numër të ndryshëm të lloptopëve në bazë të numrit të nxënësve të komunës përkatëse, dhe më datë 13 maj 2020 kemi bërë pranim dorëzimit të këtyre lloptopëve ku 8 prej tyre janë për Gjimnazin “Aleksandër Xhuvani”, 8 për shkollën ekonomike dhe 9 lloptop janë për shkollën teknike, kurse si do t'i përdorin ata lloptop unë besoj se më mirë se që e dinë drejtori përkatës i shkollës, nuk e di as unë e as ju si asamblist, uroj që drejtorët e shkollave përkatëse ti përdorin dhe t'ju japin në shfrytëzim atyre që kanë nevojë.

Sa i përket çështjes së pjesëmarrjes, ne rregullisht kemi raportuar edhe në Ministrinë e Arsimit, raporti i fundit që e kemi dërguar dhe që ka të bëjë me nxënësit të cilët nuk kanë mundur ta vijnë mësimin është rreth 2.64%, pra në bazë të raporteve që kemi marrë nga shkollat, informatë të cilën e kemi përcjellë edhe në Ministri e cila është duke u marrë me këtë çështje që këtyre fëmijëve (të paktën kështu na kanë thënë) t'iu gjejnë forma dhe t'iu sigurojmë pajisje nëse veç mësimi organizohet dhe zhvillohet në formën nga distanca.

Prej muajit në muaj kemi parë që ka ndryshuar pjesëmarrja e nxënësve, pra ka pas laramani e që nënkupton edhe ato vështirësitë e nxënësve që i specifikova më herët e që rezulton me 2.64% të nxënësve. I kemi të nxjerra notën mesatare për këtë vit por nuk e kam parë relevante ta prezantojmë këtë duke pas parasysh gjendjen të cilën kemi pas në fund të këtij viti mësimit.

Edhe njëherë ju falënderoj të gjithëve për sugjerimet, vërejtjet, kritikën dhe gjitha çështjet e adresuara këtu por edhe në forume tjera të jeni të bindur se do t'i marrim parasysh të gjitha ato për të cilat jemi kompetent ne si Drejtori e Arsimit, por janë shumë çështje të cilat nuk varen nga Komuna dhe këtë ua them me përgjegjësi të plotë ngase janë çështje të nivelit qendrorë dhe politikave qendrore dhe lidhur me atë që u cek se është granti specifik për arsim mund t'ju them se pikërisht këtu është problemi në fushën e arsimit me theks tek investimet kapitale ngase thirrmi që kemi grantin specifik kurse investimet kapitale i ndan dhe investon Ministria, por a i investon aty ku është e nevojshme shpeshherë kemi pas dhe jemi në dijeni nga përvoja jonë se shpeshherë nuk është investuar në vende ku janë më të nevojshme. Ndoshta në takimet e ardhshme do të kemi rastin që t'i prezantojmë edhe projektet ku janë duke u realizuar dhe ku do të realizohen në të ardhmen.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sigurisht se në kushtet dhe rrethanat që jemi edhe arsimi ka pasë dhe do të ketë probleme mirëpo kërkohet nga të gjithë që të angazhohemi në mënyrë që ta përballojmë sa më lehtë këtë situatë. Meqë nuk ka të lajmëruar të tjerë për të marrë fjalën, e konstatoj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

2. Informatë e përgjithshme e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit

z.Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit - DSHPMSh, e paraqiti fjalën hyrëse duke nënvizuar që në respekt të kohës dhe rrethanave që jemi do të përpiqem që sa më shkurt të paraqes informata rreth punëve dhe aktiviteteve të Drejtorisë ngase informata ju është dërguar në formë të shkruar. Ndër të tjera theksoi, deri më tani furnizimi me ujë është i kënaqshëm edhe pse nuk ka reduktime të planifikuara, sipas njësisë operative në Podujevë gjendja e furnizimit me ujë deri më tani është 8648 konsumator, shkalla e inkasimit është rreth 75%.

Dy çështjet me të cilat përballemi edhe ne si komunë por edhe Ujësjetësi janë vështirësitë në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjetësit, n'kuadër të këtij edhe mirëmbajtja e kanalizimeve në terrenet ku vepron ujësjetësi dhe dëmet e shkaktuara në infrastrukturë publike (rrugë, trotuare dhe hapësira tjera publike) gjatë riparimit të rrjetit. Lidhur me këtë ne kemi pas disa takime, madje edhe me kryeshefin e kësaj kompanie kur ka qenë në vizitë në Komunën e Podujevës i kemi diskutuar këto çështje dhe kemi marrë hapa konkret në këtë aspekt.

Gjatë reshjeve të fundit, për fat të mirë liqeni i Batllavës ka pas një ngritje të nivelit të akumulimit të tij, kur e kam përgatitur dhe dërguar këtë informatë ka qenë 5.91 në nivelin e kapërdedhjes ose në nivelin maksimal të mbushjes. Investimet e përbashkëta që kemi edhe investimet që ka Ujësjetësi janë në fshatin Sallabaj ku do të bëhet ndërrimi i rrjetit tërësisht diku rreth 8700 metra gjatësi, Komuna e Podujevës ka në fazën e tenderimit rr.”Kongresi i Manastirit” në qytet e cila do të jetë

edhe me infrastrukturë tjetër përcjellëse. Realizimi i projektit të Orllani deri tani është diku rreth 60% në gjatësi rreth 42 km gjatësi dhe Komuna e Podujevës ka përfunduar pothuajse të gjitha obligimet që ka pas në bazë të Memorandumit që kemi me MMPH (pagesë 121,000.00€), hartimi i projektit zbatues, dhe meqë projekti mund të ketë zgjatje në disa lagje, Komuna ka shpreh gatishmëri që të jemi bashkë financues. Planifikimet për vitin e ardhshëm i kemi bërë kryesisht së bashku, projekti më i madh do të jetë ndërimi i gypit furnizues për rezervuarët e qytetit në gjatësi rreth 2.1 km, me diametër 400 mm, dhe me një kosto e cila në bazë të parallogaritjeve është rreth 400,000.00€, do të thotë këtë vit kemi një shumë të madhe të buxhetit për pjesëmarrje në rrjetin e ujësjellësit.

Sa i përket menaxhimit të mbeturinave, gjendja aktuale është, amvisëri 8002, biznese 744, me kontrata të veçanta 82 biznese, 53 institucione varësisht se ku veprojnë kompanitë përkatëse. Të gjitha institucionet janë të përfshira në sistemin e menaxhimit të mbeturinave, por mbeten dy çështje që ende duhet të punojmë, zgjerimi i territorit të menaxhimit të mbeturinave mund të themi se është i kënaqshëm ndërsa shtimi i ekonomive, posaçërisht familjare është çështje për të cilën ende duhet të punojmë, prandaj nga muaji gusht Komuna, kompanitë por edhe ju të nderuar këshilltarë të Kuvendit është mirë të ndikoni që amvisëritë të përfshihen sa më shumë në këtë sistem të menaxhimit të mbeturinave. Gjatë këtij viti Komuna ka kryer fazën e parë të largimit të deponive ilegale të mbeturinave në 48 lokacione të ndryshme kurse jemi në fazën e procedurave të tenderimit edhe për 44 lokacione tjera e që dukshëm do të ndikojnë në pastrimin e ambientit. Në përgjithësi në fshatin Batllavë kemi pas telashe sa i përket mirëmbajtjes së mbeturinave të cilat kryesisht bëhen vikendeve nga pushuesit që vizitojnë atë pjesë, por kemi angazhuar dy punëtor dhe së bashku me kompaninë janë duke u larguar mbeturinat e hedhura nga qytetarët që vizitojnë atë pjesë.

Gjendja e furnizimit me rrymë është e drejtë e plotë e KEDS-it, investimet në Komunën e Podujevës janë bukur të mëdha në territorin e Komunës së Podujevës gjë të cilën keni mundur ta vëreni secili por më shumë jemi marrë me probleme të ndryshme sepse Komuna jep pëlqime për ndërhyrje në infrastrukturë nga ana e KEDS, mirëpo ka rreth dy javë që jemi në bisedime me KEDS sepse siç jeni në dijeni investimet në infrastrukturë janë bukur të mëdha kurse pas ndërhyrjes së KEDS në infrastrukturë publike nuk po kthehet menjëherë në gjendjen e mëparshme trotualet dhe asfaltet ku po ka ndërhyrje e që nuk janë të pakta, posaçërisht në qytet.

Sa i përket transportit publik, është një sektor i cili është goditur jashtëzakonisht shumë nga situata e krijuar nga pandemia e që edhe ne si Komunë jemi ballafaquar me këto probleme si pasoj e kufizimeve sepse për një kohë të gjatë nuk kanë punuar fare, pastaj punojnë me kapacitete të kufizuara në bazë të masave të fundit të Qeverisë e që një pjesë e tyre kanë shprehur edhe skepticizëm që nëse vazhdojnë gjatës këto masa ndoshta do të kenë problem të vazhdojnë.

Komuna e Podujevës ka lëshuar të gjitha lejet për autobusët, minibusët, kompanive të taksive etj, të gjitha pa pagesë sipas vendimeve të mëhershme për lirim të bizneseve e që ndikojnë sa do pak në gjendjen e tyre ekonomike.

Po ashtu bashkëngjitur në informatë keni edhe një listë telegrafike të projekteve të deritanishme që janë realizuara, atyre që janë në procedurë dhe atyre që do të realizohen, andaj nuk po zgjati më shumë, por për çka do që jeni të interesuar mund të jap sqarime dhe përgjigje të nevojshme.

znj.Valbone Kadriu, theksoi, duke u bazuar në informatat e përgjithshme të DSHPMSh, vlerësojmë gjendjen e mirë të furnizimit me ujë sidomos përpjekjet e kompanisë ujësjellësi që të ketë sa më pak reduktime të ujit dhe njëkohësisht kërkojmë punë të shtuar të inspektimit nga kompania dhe Komuna në mënyrë që të ketë sa më pak keqpërdorim të ujit në mënyrë që të mos ketë reduktime sa i përket furnizimit me ujë.

Përkrahim Komunën në dy problemet theksuara në informatë dhe të cilat kërkojnë punë më të madhe të kompanisë të mirëmbajtjes dhe të investimit sidomos në gjendjen e infrastrukturës për investime. Po ashtu punë e mirë dhe që duhet të vazhdoj janë investimet e përbashkëta të planifikimit për çdo vit dhe investime në rrjet, sidomos i rëndësishëm së veçantë është investimi i përbashkët si dhe mundësia që edhe donatorët të marrin pjesë në gypin e ri dhe me kapacitet të mjaftueshëm për furnizim të qytetarëve me ujë të pijes.

Sa i përket menaxhimit të mbeturinave, në informatë janë dhënë shifra të sakta të amvisërive, bizneseve dhe institucioneve që janë të përfshirë në sistemin e menaxhimit të mbeturinave por që një angazhim i shtuar është për kyçjen e atyre që nuk janë në sistemin e menaxhimit të mbeturinave. Gjithashtu përkrahim nismën, që nga muaji gusht, zyrtarë të Komunës, ata të kompanive por edhe nga vetë ne këshilltarët e Kuvendit të mundohemi të ndikojmë, atje ku mundemi, në mënyrë që të kemi rritje të numrit të amvisërive që janë në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.

Jemi të informuar për largimin e shumë deponive ilegale dhe vazhdimin e largimit të deponive të tjera në shumë lokalitete sepse po shohim se largimi i tyre po ndikon shumë në një ambient më të pastër.

Lidhur me dinamikën e projekteve kapitale vërehet se ka projekte që kanë përfunduar, por në shumicën e projekteve është duke u punuar dhe shpresojmë që realizimi i projekteve kapitale dhe realizimi i buxhetit të planifikuar të realizohet në tërësi.

z.Pajtim Balaj, theksoi, furnizimi me ujë në Komunën e Podujevës nuk është i mirë, mirëpo e dimë gjendjen e mungesës së borës gjatë dimrit kështu që për këtë punë nuk kemi pse ta fajësojmë Drejtorisë ose këdo që merret me furnizim me ujë siç janë kompanitë, por që është problematike që të futet në raport si gjendje e mirë kur nuk është.

Parku i qytetit i cili gjendet vetëm disa metra larg kësaj sale ku jemi, është shndërruar në deponi mbeturinash e që dikush mund të thotë se faji është i qytetarëve - individëve të papërgjegjshëm mirëpo unë mendoj që institucionet publike kanë për detyrë tu përshtaten dhe tu përgjigjen nevojave të qytetarëve, nëse sasia e mbeturinave është gjithmonë e madhe faji është i kompanive që nuk bëjnë grumbullim më të shpeshtë të tyre dhe nuk e rrisin numrin e kontejnerëve, ngjashëm është edhe me deponin afër (siç është referuar raporti në gjuhën serbe) silosit të cilit shqip mund t'i referohemi si drithniku, ku njëjtë është gjendja edhe në atë pjesë dhe nëse përkundër pastrimit që i bëhet disa herë në javë prap ka sasi të madhe të mbeturinave dhe prap është faji tek kompania që nuk e rritë numrin e kontejnerëve, nuk i futë në listë të menaxhimit të mbeturinave ekonomitë dhe bizneset familjare që gjenden në atë zonë. Problem tjetër është edhe tregu i gjelbër që gjendet vetëm disa metra larg kësaj deponie i cili përkundër që nga ish Kryetari i Komunës është përruruar në zgjedhjet lokale të vitit 2017, vazhdon të mbetet i mbyllur, ndërkohë që vetëm disa metra larg kësaj deponie prodhuesit e produkteve të qumështit i shesin produktet e tyre në një treg joformal që është krijuar aty, ndërkohë që tregu vazhdon të mbetet i mbyllur. Problemet në këtë çështje vijnë nga mos funksionalizmi i tregut, mos kyçja e bizneseve dhe ekonomive familjare në mbledhjen e mbeturinave, mungesa ndoshta e një kompanie lokale publike të mirëmbajtjes dhe mungesa e efikasitetit të inspektoratit në shqiptim të gjobave. Çështja e deponive të vogla ilegale zgjidhet duke shtrirë rrjetin e grumbullimit nëpër çdo vendbanim dhe duke krijuar mekanizma ndëshkimes ndaj individëve të papërgjegjshëm të cilët hedhin mbeturina kudo për t'iu shmangur pagesave shumë të vogla që mund të bëhen për kryerjen e këtyre shërbimeve, andaj në këtë drejtim konsideroj se duhet një plan veprimi për zbatimin e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave.

Mungesa e shportave të mbeturinave nga ekonomitë familjare dhe shpërndarja që bëhet nga qentë endacak është përmendur në raport si një problem, nuk jam në dijeni nëse kompania ka mekanizma obligativ ndaj banorëve, por të paktën të përpiqen që t'iu rekomandohet ose sugjerohet banorëve dhe

ekonomive të tjera që të blejnë dhe të përdorin shporta të mbeturinave në mënyrë që kjo çështje apo ky problem të evitohet.

Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit duhet t'i bëjë më shumë presion KEDS-it për sanimin e gropave të shkaktuara gjatë instalimeve të tyre të cilat edhe kur i kryejnë i kryejnë "shkel e shko" kurse gjendja mbetet shumë e vështirë, gjë të cilën si çështje e kam ngritur edhe në një prej mbledhjeve të kaluara. Po ashtu jo më mirë është edhe Komuna në disa gjërmime nëpër disa rrugë të disa pjesëve të qytetit kohëve të fundit ku gropat vazhdojnë të mbeten ashtu të hapura për shumë javë e muaj dhe të cilat e vështirësojnë qarkullimin e automjeteve, të banorëve dhe çiklistëve të cilët janë goxha në numër kohëve të fundit në Komunën tonë. Problemet në këtë pikë shkaktohen nga planifikimet e gabuara dhe gjërmimet pa plan dhe mos koordinimi mes Komunës dhe kompanive publike si dhe investimet absurde që Komuna i bënë në asetet e ndërmarrjeve publike e që për të ardhmen si një zgjidhje afatgjate Komuna duhet të caktoj kompanive një tarifë në vlerë monetare, pra fjala është për kompanitë publike ose private që kryejnë gjërmime për ndërhyrje në rrugë dhe trotuare dhe për ndërhyrje të çfarëdo rrjeti, sipas vlerësimit të Komunës në mënyrë që pas riparimit këto rrugë, trotuare të kthehen në gjendjen e mëparshme dhe në kohë sa më të shpejtë.

Një çështje që konsideroj se është emergjente për qytetarët është edhe transporti publik i cili përballet dhe shoqërohet me probleme si, mos funksionalizimi i stacionit të autobusëve, mungesa e stacioneve pritëse si në qytet dhe në fshatra si dhe kryesorja është mungesa e një linje të transportit publik që do të qarkullonte në qytet për t'i lehtësuar nevojat e qytetarëve por gjithashtu edhe e cila do të ndikonte në rritjen e sigurisë së trafikut publik, për shkak se do të ulte numrin e makinave në rrugë. Mandej t'i kushtohet fokus i veçantë zgjerimit të lumenjve dhe proçkave, temë kjo për të cilën kemi diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar dhe që kemi propozuar një deklaratë të cilën nuk e keni marrë parasysh, por të paktën që të mos përballemi prap për të njëjtat çështje shpresojë se do të merrni masa.

Një çështje që nuk është prekë fare në raportin e DSHPMSH janë parqet e sidomos Parku i Paqes i qytetit në të cilin janë bërë investime të qëlluara me krijimin e stazave për ecje dhe vrapim dhe ndriçimi publik mirëpo gjendja në këtë park është shumë e keqe në ulëset dhe pushimoret që janë brenda në atë park ku shumica janë të dëmtuara, andaj përveç nevojës që të ndërtohen ulëse shtesë është edhe nevojshme që të riparohen ato ulëse që janë dhe të rritet numri i peronave kujdestar të këtij parku të cilët përveç që do ta ruanin parkun nga prerjet e vrazhda që shpesh iu bëhen drunjve edhe do të përkujdeseshin për mirëmbajtjen e parkut në përgjithësi, park i cili po ashtu përveç këtyre investimeve ka nevojë edhe për pastrimin e tërësishëm duke i larguar drunjat e dëmtuar dhe duke i zëvendësuar me drunjë të rinj.

z.Fatmir Rudari, theksoi, dëshiroj të ndalem vetëm tek çështja e Shërbimit të Zjarrfikjes, ditëve të fundit kemi parë nëpër media se janë disa telashe brenda këtij shërbimi, andaj kërkoj një opinion të drejtorit të DSHPMSH lidhur me këtë çështje, kjo ngase në informatën e dërguar mungon çështja e zjarrfikësve, ndërsa për çështjet tjera rreth kësaj Drejtorie u diskutuan nga parafolësit dhe nuk dëshiroj të përsërisë.

z.Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, lidhur me çështjen e kërkuar nga këshilltari parafolës rreth Njësisë së Zjarrfikjes, raportet mes shefit të njësisë dhe punëtorëve tjerë të kësaj njësie janë duke u trajtuar nga Agjensioni për Menaxhimin e Emergjencave n'kuadër të të cilit nga viti 2012 funksionon Njësia Operative e zjarrfikësve në Komunën e Podujevës ashtu siç funksionon në gjithë Kosovën. Pra është duke u trajtuar një kërkesë / ankesë e punëtorëve dhe tani është çështje e cila siç e ceka është në trajtim dhe ende nuk kemi ndonjë vendim përfundimtarë të këtij organi si shkallë e dytë kështu që duhet të presim procedurat përkatëse mirëpo çështja e funksionimit të kësaj Njësie ka vazhduar normalisht pavarësisht që ka pas një mos komunikim mes shefit dhe 12 punëtorëve, ndërsa

punët e përditshme janë në nivelin më të lartë. Sa për rikujtim Njësia në fjalë para disa ditësh është pajisur edhe me një automjet nga Ambasada e Japonisë të cilët i falënderojmë nga këtu.

Sa i përket çështjeve tjera të ngritura falënderojmë të gjithë këshilltarët për sugjerimet e tyre sepse vërtetë çështjet e ambientit, furnizimit me ujë dhe çështjet e infrastrukturës janë çështje që nuk do të mbyllën asnjëherë dhe nuk mund të jemi të kënaqur me cilësi sepse kjo çdo herë duhet të vazhdoj posaçërisht në parqe e të tjera, çështje të cilën nuk e kam trajtuar në informatë sepse Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka sektorin përkatës kështu që nuk kam ndërhyrë në atë çështje. Vlen të theksohet në parkun këtu afër, prapa lumit Llap, tash së fundmi kemi vendosur apo më mirë të them rivendosur një ndriçim dhe kemi kërkuar nga Kompania “Pastrimi” të pastroj dhe mirëmbaj atë pjesë e që është duke u pastruar dhe ende duhet të vazhdoi.

Sa i përket shportave të mbeturinave, është e vërtetë se sa më shumë të ketë shporta të mbeturinave në biznese dhe amvisëri do të ishte më lehtë për të gjithë sepse forma e grumbullimit të mbeturinave derë më derë dhe me qese është e rrezikshme për arsye se nuk respektohet orari i hedhjes, shembull, nëse sot mbeturinat mblidhen në mëngjes në një pjesë të caktuar, banorët i hedhin ato një ditë ose dy më herët, pastaj paraqiten edhe problemet me qentë endacak, çështje e cila nuk ndodhë vetëm në Komunën e Podujevës por në gjithë Kosovën thuajse, por që bashkërisht me drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural problemin e qenve endacak e kemi adresuar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës të cilët kanë dhënë premtime se shumë shpejt do të ndërmerren masa, çështje të cilën po ashtu e kemi trajtuar edhe si shtab emergjentë në një vizitë që na është bërë nga zyrtarë të Qendrës Operative Emergjente, ku kemi shfaq mundësi të rrezikshmërisë për sëmundje të ndryshme që mund të barten si dhe sulmeve eventuale ndaj qytetarëve nga qentë endacak.

Problematika e ndërhyrjes në infrastrukturë në qytet vërtetë është e ndërlikuar, para dy ditësh unë bashkërisht me disa drejtorët e Drejtorive përkatëse kemi pas një takim me kompanitë e interneteve të cilat nuk kanë në marrëdhënie kontraktuale me KEDS siç i kanë pas më përpara, pastaj në pjesë të ndryshme ndërhyjnë Komuna, ndërhyjnë KEDS, ndërhyjnë kompanitë e interneteve, andej edhe jua kemi bërë shumë të qartë se nuk ka veprim të kompanive të internetit në shtyllat metalike të ndriçimit publik sepse atëherë për çka ne po investojmë, pastaj po investon KEDS për futjen e gypave dhe rrjetit nëntokësorë me qëllim të largimit të problemeve që janë të mëdha, posaçërisht në qytet. Sa i përket furnizimit me ujë, unë sërish e them se gjendja e furnizimit me ujë është e mirë aty ku është i shtrirë rrjeti, mirëpo jemi në dijeni se në shumë fshatra nuk ka shtrirje të rrjetit të ujësjellësit, andaj nuk mund të themi se gjendja është e keqe, pra nuk ka reduktime zyrtare sepse do të lajmëronin për një gjë të tillë, mirëpo ka probleme në disa lagje ku për fatin e keq shumë qytetarë bëjnë ndërhyrje ilegale në rrjetin e ujësjellësit për çka ka inspektime të shpeshta të dyanshme, dhe ujitin ara, kopshte etj, e që pastaj disa pjesë të larat të qytetit dhe pjesëve tjera nuk kanë furnizim me ujë të pijes.

Unë edhe njëherë ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhen, ndoshta nuk i bëra gjitha përgjigjet dhe sqarimet e nevojshme për të gjitha çështjet që u ngritën mirëpo të gjitha vërejtjet, sugjerimet qëllimmira të juaja dhe më gjerë i kam evidentuar dhe do t'i marrë parasysh me qëllim që të përmirësimi dhe shërbimet të jenë çdo herë e më shumë në interes të përgjithshëm.

Falënderim i veçantë shkon edhe për kompanitë të cilat kanë punuar në mirëmbajtje gjatë periudhës fillestare të pandemisë, posaçërisht kur qenë periudha e karantinës në për fshatra e që për ne ka qenë një lloj panike por që kanë punuar edhe KEDS, kompanitë e dezinfektimeve, kompanitë e menaxhimit të mbeturinave etj, të cilat posaçërisht kanë pasur problem t'i dërgojnë punëtorët, shembull, në fshatin Dumnicë kur ishte një frikë fillestare se çfarë po ndodh, por që çdo herë iu janë përgjigje çdo kërkesë të Komunës së Podujevës, dhe shtabit emergjent, andaj vërtetë meritojnë

falënderim sepse ka qenë një periudhë e vështirë atëherë përkundër që tani disi jemi ambientuar me këto problematika dhe sot kemi rreth 30-40 kompani të cilat punojnë dhe nuk i kemi ato telashe.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën unë i falënderoj të gjithë për kontributin e tyre të dhënë, gjithnjë me qëllimin pozitiv që shërbimet publike gjithëherë të jenë sa më të avancuara si punët dhe aktivitetet të jenë gjithnjë e më shumë në shërbim të qytetarëve të Komunës së Podujevës, andaj e konstatoj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

3. Informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, rreth gjendjes së krijuar nga coronavirusi Covid-19 në territorin e Komunës së Podujevës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, tani më siç edhe jeni të informuar nga konstatimet e rekomanduara të KPF-së kjo pikë e rendit të ditës ka hyrë si pikë shtesë, andaj edhe pse është një kohë shumë e shkurtër për tu përgatitur për një informatë të tillë marrë parasysh edhe punët dhe aktivitetet që zhvillohen në këtë situatë që jemi nga ana e Drejtorisë përkatëse, shpresoj që drejtori i DSHMS-së është përgatitur dhe do të na paraqet një informatë të tillë.

z.Zaim Thaqi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, e paraqiti informatën në fjalë, ndër të tjera theksoi, jemi në dijeni për situatën epidemiologjike nga coronavirusi Covid-19 e vlerësuar dhe shpallur më pastaj nga OBSH nga muaji mars pandemi e Covid-19 si dhe e shpallur si emergjencë e shëndetit publik.

Edhe pse Komuna e Podujevës si një ndër komunat e para të prekura me Covid-19 por që në numër të vogël në krahasim me komunat tjera, lirimi i masave, me theks në muajin qershor, dhe relaksimi i tyre bëri që numri i rasteve me Covid-19 të rritet. Aktivitetet e DSHMS të ndara kryesisht në dy komponentë, atë shëndetësore dhe atë sociale vazhdojnë pandërprerë nga 15 marsi 2020 me shërbime 24 orë, me shërbime të përforcuara kryesisht në pikat ku janë të infektuar pacientët me Covid-19 si atë me shërbimin e triazhimit apo siç po quhet shërbimi i Covid-19, si dhe pikën permanente që nga muaji mars me ekipen mjekësore në pikën kufitare në Merdar.

Me komponentën mjekësore jemi duke punuar pa ndërprerë duke i falënderuar profesionistët shëndetësorë të cilët absolutisht nuk kërkojnë pushime mjekësore, ose vjetore por janë të përkushtuar që shërbimet esenciale të vazhdojnë me një ritëm siç ishte në muajin mars.

Me komponentën sociale veç jemi të njohur sepse nga këtu si Kuvend i Komunës kanë buruar iniciativat dhe vendimet me të cilat i kemi mbështetur qytetarët me pako ushqimore dhe higjienike.

Prej shërbimeve që mund të veçohen dhe e cila ka qenë kërkesë e jona e që tash veç njihemi si Komuna e 6 në gjashtë regjionet e Kosovës që jemi duke aplikuar marrjen e mostrave për Covid-19 dhe kjo bëhet nga një ekip e specializuar prej laborantëve të cilët për çdo ditë marrin prej 15 deri në 25 mostra dhe kjo ka lehtësuar shumë kontaktin me qytetarë dhe shërbimin shëndetësor si dhe shpesh herë edhe heqjen e mëdyshjeve por njëkohësisht edhe menaxhimin e situatës me Covid-19.

Kemi 4 ekipe mjekësore të cilat janë duke punuar 24 orë sa i përket covid-19, ku 1 ekipë e tillë është e përbërë prej 1 doktorri dhe 1 infermieri, e që 1 ekipë gjithëherë është në pikën kufitare në Merdar.

Deri më tani kemi testuar 840 qytetarë për covid-19, 114 janë të shëruar, 112 janë raste aktive dhe fatkeqësisht i kemi 8 ekzituese, pra gjithsej prej datës 15 mars të këtij vitit kemi 234 raste të prekur me covid-19 e që në përqindje i bie që 28% e të testuarëve kanë rezultuar pozitiv me këtë virus.

Ekipa mjekësore në pikën kufitare në Merdar deri tani ka ofruar rreth 32000 vizita mjekësore qytetarëve të cilët hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës ndërsa ekipa mjekësore e covid-19 që është një shërbim i veçantë deri më tani ka ofruar rreth 3000 vizita mjekësore qytetarëve në

ambientet e institucionit shëndetësor dhe në shtëpitë e atyre qytetarëve të cilët kërkojnë shërbim shëndetësorë.

Pra kjo ishte një informatë e shkurtër në bazë të asaj çfarë është kërkuar, kurse në rast se keni ndonjë interesim për ndonjë çështje të caktuar rreth situatës me covid-19, unë absolutisht jam i gatshëm t'ju jap përgjigje

z.Afrim Shabani, theksoi, sa i përket informatës rreth gjendjes së krijuar nga coronavirusi covid-19 në territorin e Komunës së Podujevës, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e mbështesim këtë informatë për të cilën e dëgjova me vëmendje drejtorin e DSHMS-së për çka e falënderoj dhe për çka Komuna e Podujevës ka treguar potencial të mirë të menaxhimit dhe për marrjen e masave në parandalimin e përhapjes së virusit e që gjithçka po bëhet për të dhënë rezultate të mira për ruajtjen e shëndetit publik.

Vlen të theksohet se Komuna e Podujevës në bashkëpunim me drejtorin e DSHMS-ës dhe QKMF-së kanë ndërmarrë këto masa edhe që nga fillimi i pandemisë si ngritjen e ekipës mjekësore në pikën kufitare e cila funksionon 24 orë, shërbimin e triazhimit për covid-19 në QKMF e cila ka në posedim edhe numrin e telefonit falas 24 orë për të gjithë qytetarët, mobilizimin e Shërbimit të Emergjencës, organizimin e punës në terren me ekipet mjekësore të cilët kujdesen për të sëmurit me covid-19 që janë pozitiv, dezinfektimin e vazhdueshëm të QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve në përgjithësi si dhe furnizimin e mjete dhe pajisje mbrojtëse nga Ministria e Shëndetësisë si dhe nga Komuna e Podujevës. Në gjendjen aktuale në të cilën gjendemi nuk mund të themi se jemi në një situatë të lehtë për të menaxhuar me pandeminë sepse nuk varet nga një institucion i vetëm por janë me rëndësi edhe faktorët tjerë të përbashkët ku institucionet komunale janë duke punuar vazhdimisht në parandalimin e përhapjes së këtij virusi si dhe kam shpresë në rritjen e vetëdijesimit të qytetarëve që të respektojnë udhëzimet e ekspertëve shëndetësorë me qëllim të mos rritjes së numrit të të infektuarve dhe duke respektuar masat parandaluese të nxjerra nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës.

Me theks të veçantë dëshiroj të përmend edhe një problematikë e cila në vazhdimësi na ka atakuar e që ka të bëjë me mungesën e personelit mjekësorë dhe stafit mbështetës në QKMF e sidomos tani në kohën e pandemisë e që shpresoj se do të gjendet një formë dhe mënyrë që të rritet numri i të punësuarve në këtë drejtim dhe njëkohësisht shfrytëzoj rastin t'i falënderoj të gjithë punëtorët të cilët janë duke bërë një punë aq të mundimshme dhe sfiduese për mbrojtjen e shëndetit për popullatën tonë.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, fillimisht falënderoj të gjithë anëtarët e KPF-së për përkrahjen dhe mbështetjen unanime lidhur me futjen e kësaj pike n'kuadër të rendit të ditës për këtë seancë. Kemi pritur që kjo informatë ta na sjellët kohë më parë por si duket Ekzekutivit të Komunës nuk i bëhet vonë për asgjë, dhe për këtë arsye ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së e pamë të arsyeshme që të na sjellët një informatë e tillë. Pra ne jemi në dijeni se sikurse në gjithë Botën ashtu edhe në Kosovë por edhe në komunën tonë rastet me covid-19 sa vijnë dhe shtohen, mirëpo në ditët e fundit jo vetëm me të infektuar por edhe me raste të të vdekurve. Në QKMF – Podujevë punon ekipa kujdestare 24 orë - covid-19 ku zakonisht ky ekip për shkak të fluksit të madh të të prekurve me covid-19 punon në terren, dhe tani së fundmi bëhen edhe testet për përcaktimin e analizës për covid -19 por që teste të tilla bëhen vetëm për 5 persona ku për të bërë këtë test duhet pritur gjerë dhe gjatë e që në shumicën e rasteve pacientët shërohen duke pritur në listën e gjatë të pritjes e në shumicën e rasteve të rëndomtë këtyre nuk iu vie radha pasi që në vend të tyre testohen njerëz nga Ekzekutivi i Komunës dhe familjarët e tyre.

Disa raste me covid-19 përveç terapisë infuzive duhet të trajtohen edhe me oksigjen por nuk e di Ekzekutiv i nderuar se a jeni në dijeni se prej datës 17.07.2020 në QKMF nuk ka oksigjen kur duhet

se oksigjeni është i domosdoshëm jo vetëm gjatë pandemisë por edhe për raste të tjera që trajtohen në Emergjencë, pra përveç mungesës së oksigjenit ka edhe mungesë të mjeteve dezinfektuese në hyrje dhe dalje të korridoreve dhe ordinancave të QKMF-së e mos të flasim për ambulanca, punkte shëndetësore dhe autoambulanca që barten pacientët për trajtim në QKUK.

Të nderuar kolegë, ne Grupi i LVV-së kërkojmë që të bëhet kërkesë urgjente në Ministrinë e Shëndetësisë, të shtohen testet për përcaktimin e analizës e covid-19, të furnizohet në mënyrë të rregullt me oksigjen dhe rezerva ta saj të mos ketë mungesë sidomos për rastet emergjente, të vazhdoj dezinfektimi i hapësirave të QKMF-së dhe pikave të tjera të kontrollit të pacientëve të dyshuar proces ky i ndërprerë që dy muaj, familjeve të izoluar Komuna t'ju siguroj pako ushqimore dhe higjienike gjatë kohës së izolimit, të rritet stafi punues për kujdestarinë për covid-19 në mënyrë që pacientët të trajtohen edhe në QKMF-Podujevë e jo tenda të qëndrojnë vetëm si suvenir, pastaj kërkojmë urgjent që sikurse në të gjitha Komunat e Kosovës që është përfshirë edhe opozita në Shtab Emergjent të përfshihet edhe opozita e jo të lihet anash.

z.Avni Islami, theksoi, edhe në seancën e fundit e cila ishte e jashtëzakonshme, por edhe sot është dashur të ngritet kjo çështje ose kjo dukuri e cila na ka përfshirë neve të gjithëve, pra fjala është pandeminë covid-19.

Unë mora fjalën që të ngrisë një shqetësim ku jam i bindur që edhe ju por edhe qytetarët tjerë janë duke i parë njerëzit të cilët janë ose që rezultojnë pozitiv me covid-19, ndërsa të njëjtit lëvizin lirshëm nëpër qytet, dalin blejnë gjësende, marrin pjesë nëpër varrime dukuri për të cilën do t'i adresohesha Shtabit Emergjent ku pjesë përbërë e tij është edhe Komandanti i Stacionit të Policisë por edhe gjitha strukturat tjera përgjegjëse për covid-19, dhe është mirë që kjo çështje të shqyrtohet sa më shpejt që është e mundur në mënyrë që të jetë edhe një numër kontaktues në Komunën e Podujevës ku secili qytetarë i cili ka mundësi të thërras dhe ta identifikoj peronin i cili ka rezultuar pozitiv me covid-19, person i cili me daljen e tij në qytet për vet faktin që ka dal paraqet edhe vepër penale për shkak se me vetëdije po bënë përhapjen e një sëmundje e cila mund të shkaktoj edhe vdekje, kështu që i nderuar drejtor i DSHPMSh z.Faik Muçiqi dhe të tjerët që jeni në Shtab Emergjent është mirë të ndërmerren masa të menjëhershme për shkak se besoj që të gjithë në mesin tonë çka jemi kemi parë raste të tilla.

z.Bajram Ajeti, theksoi, pa qëllim të politizimit apo diçka tjetër të ngjashme, megjithatë më shtyri të marrë fjalën fjalimi i parafolësit i cili e tha se, unë di raste që njerëz të infektuar dalin dhe kontaktojnë, pastaj e potencoj se, ai që del shkakton vepër penale, mirëpo vepër penale është edhe për atë që e dinë se dikush bënë vepër penale dhe nuk e lajmëron, andaj unë mendoj se ajo që u potencua ishte papërgjegjësi e thënë apo vetëm sa për të thënë diçka.

Pajtohem për atë se duhet të jemi serioz të gjithë, por mënyra se si u tha kjo nga parafolësi, mendoj se ishte shumë kontroverse dhe e pakuptimtë, përveç asaj që duhet të jemi të kujdesshëm për mbrojtjen nga coronavirusi.

z.Avni Islami, i drejtohet parafolësit z.Bajram Ajeti, theksoi, unë nuk e mora fjalën vetëm sa për të thënë diçka dhe nuk e them që duhet të pajtohen të gjithë për atë që e thash, dhe nuk e thënë që parafolësi të pajtohet, por ti (*i drejtohet Bajram Ajetit*) përnjëmend je njeri grindavec i keq, dhe del këtu në foltore vetëm sa për të thënë diçka.

Shqetësimi im që e ceka, jam i bindur se për rreth 90% është ashtu siç po them unë.

z.Bajram Ajeti, theksoi, më duket se isha shumë i qartë sepse nuk jam që ta politizojmë një çështje të tillë, megjithatë ajo çfarë e thash unë ishin në fjalimin tënde (*i drejtohet parafolësit Avni Islamit*), pra të kesh informacione, se edhe ashtu tash je në detyra të informacioneve, në atë fushë të informacioneve je me detyrën e re, do të thotë paske informacione për njerëz të cilët lirshëm lëvizin nëpër qytet dhe shkojnë në varrime dhe të cilët e kanë coronavirusin, unë mendoj se kjo është një

fjalë me peshë të rëndë dhe kjo kur thuhet duhet goxha mirë të matet, dhe të thuhet e bazuar, andaj urdhëro i nderuar jepi 2-3 emra për këtë gjë, ndërsa për të tjerat se çfarë rreziku paraqet coronavirusi o sot e kemi të njohur dhe e dimë e që nuk kemi nevojë fare as për fjalime as për inkurajime as për motivime sepse pasojat i kemi. Prandaj i nderuar zotëri Islami, këtë unë desha ta them kështu sepse këtu ishte kontradikta juaj që ishte në vetë fjalën tënde. Unë do të jem shumë i shqetësuar nëse ju zotëri Islami e dinë se ka qytetarë të cilët janë me coronavirus dhe po shëtisin kurse unë nuk e di, jemi koleg në këtë asamble, i keni këta bashkëpunëtorët tuaj andaj na informoni neve dhe organet kompetente siç janë Stacioni i Policisë, Inspektorati i Komunës, Institucioni shëndetësor dhe të marrim masa sepse vërtetë në rast se është e vërtetë ajo që u tha vërtetë është diçka e shumë e rëndë.

z.Avni Islami, theksoi, sqarim shtesë, unë propozova që të jetë një numër i veçantë i telefonit në Komunën e Podujevës, ndërsa sa i përket asaj që a e kam lajmëruar unë apo jo ndonjë rast nuk mund të tregoj këtu sepse është çështje e diskrecioni, por unë propozova te këtë numër të telefonit që kushdo që ka informata apo që e sheh ndokënd që është pozitiv, dhe që e njeh, ta paraqes rastin.

z.Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSh, theksoi, çështja e ngritur nga parafolësi si dukuri është trajtuar disa herë në Shtabin Emergjent, mirëpo çdo rast i infektuar për çdo ditë, janë të informuar drejtori i DSHMS dhe Komandanti i Stacionit të Policisë dhe të gjithë të infektuarit janë nën përcjellje përfshirë edhe familjarët e tyre, ka pasë ndonjë rast familjarë të të infektuarve që janë dalë nga izolimi sepse nuk mund të përcillen të gjithë në çdo kohë, aq më shumë kur tani kemi raste më të shpeshta, mirëpo të gjithë e kemi obligim që në raste të tilla nëse vërejmë t'iu drejtohem Policisë. Me përjashtim që mund të ketë ndonjë rast të tillë, sa unë jam në dijeni të gjithë i përmbahen këtij detyrimi për çka edhe shpresoj t'i përmbahen sepse fundja përtej dëshirës është edhe detyrim ligjor, por në Shtab i kemi trajtuar këto problematika dhe çdo herë apelohej që të infektuarit dhe familjarët të jenë sa më të izoluar.

Ne jemi falënderues edhe për disa fshatra të cilat kanë qenë edhe në karantinë dhe iu kanë përmbajtur masave, ndoshta jo 100%, por keni mund ta vëreni në fillim të pandemisë shembull, për 1 rast, 4 fshatra kanë qenë në karantinë, e që ka qenë një humanitet dhe dëgjueshmëri e mirë.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, mora fjalën për një shqetësim timin që kam lidhur me atë që drejtori i DSHMS-së më herët i bëri vërejtje këshilltarit z.Pajtim Balaj që ta vendos maskën. Unë po e shohë si shqetësim që një faqe, Podujeva, ku qenka Nënkryetari i Komunës z.Nexhmi Rudari dhe drejtori i DSHPMSh z.Faik Muçiqi ku në postimin e fundit del me maskë të vendosur keq e që besoj se shumë qytetarë marrin shembull nga kjo dhe veprojnë ashtu siç e shohin edhe Ekzekutivin.

Pra kjo dukuri është duke u paraqitur prej faqes së Komunës së Podujevës, kështu që është shqetësuese kjo. Po ashtu të mos përdorët të bëhet fushatë duke ju shpërndarë maska njerëzve që kishin maska. Nëse dalim te lumi do të shohim se asnjë person nuk ka të vendosur maskë, kurse ishit shku shpërndajshi maska tek njerëzit që kanë maska, kjo është e tepërt, andaj i nderuar drejtor i DSHMS duhet të reagoni edhe për këto, jo vetëm ndaj asamblistëve.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, megjithëse ndoshta paksa me vonesë është paraqitë kjo kërkesë për një raportim më të detajuar mirëpo si do që të jetë hyri si pikë shtesë e rendit të ditës dhe situata shëndetësore dhe covid-19 është situatë e cila më herët e ka kapluar vendin si në nivel nacional ashtu edhe lokal.

Pyetje direkte për drejtorin e DSHMS-së është se duhet ta dijmë të paktën sa familje janë të izoluar për shkak të infektimit me covid-19 të ndonjë anëtar/ëve të saj, mandej numri i të infektuarve është duke u rritur si në nivel vendi ashtu edhe në nivel Komune, a ka marr masa shtesë DSHMS apo Shtabi Emergjent duke ndryshuar situata me pandeminë apo është në të njëjtin hapa me strategjinë për arsye se pandemia po rritet prej ditës në ditë kurse prej Shtabit Emergjent të paktën zyrtarisht nuk kam parë plan të ri mbrojtës, për arsye të zgjerimit.

Duke dëgjuar fjalimin e koleges znj. Adelinë Stublla dhe kërkesat e paraqitura në institucionin përkatës, a janë të pajisur me masa mbrojtëse të gjithë personeli shëndetësorë i cili është në vijën e parë të frontit, fjala është për rroba, dezinfektant, doreza, dezinfektues të personelit, në qendrat e mjekësisë familjare dhe në Ambulnatat shëndetësore, qoftë edhe nëpër fshatra ku janë aktive, a është përfunduar testi i të gjithë familjarëve ku në X (iks) familjen ka ndodh një infektim apo është bërë test vetëm personit të infektuar, dhe mandej ta dimë saktë sa familjarë janë të infektuar dhe a u është bërë testi gjithë atyre familjarëve si dhe a janë në menaxhim të plotë, jo në censurim por në menaxhim. Kështu që të paktën drejtori i DSHMS-së nëse mundet të japë përgjigje në këto pyetje sepse drejtori mund të ketë disa të dhëna të cilën po dalin në lajme e që numri ka mbërri mbi 100 të infektuar në territorin e Komunës së Podujevës, pra prej cilave zona janë më shumë të prekur, a është kryer testimi i të gjithë familjarëve të të prekurve, të paktën aty ku e dimë dhe që është publik, a keni plan dhe hapa të rinj mbrojtës në koordinim me Shtabin Emergjent, mandej i nderuar drejtor mund të na tregoni a keni ndonjë kërkesë që ne mund t'ju ndihmojmë me rishikim të buxhetit apo me ndonjë buxhet që ju keni paraparë. Pra këto janë disa prej pyetjeve për drejtorin e DSHMS-së për të cilët nëse është e mundur mund të jepen përgjigjet e nevojshme.

z. Zaim Thaqi, drejtor i DSHMS, theksoi, falënderoj gjithë këshilltarët parafolës për kontributin e tyre që japën sepse shpeshherë rekomandimet, shqetësimet, sugjerimet, vërejtjet na bëjnë që të përmirësohemi po shpeshherë ndoshta edhe të mirëkuptohemi.

Do të jap përgjigje dhe sqarime të nevojshme kronologjike në pyetjet që u paraqiten sipas radhës, sa i përket Shtabit Emergjent Komunal dëshiroj t'ju njoftoj se është një Shtab i themeluar në muajin mars të këtij viti dhe është aktiv ende, sa i përket çështjeve të testeve unë kam argumente të mjaftueshme qoftë këtu me vete qoftë të ruajtura në e-mail e të cilat mund t'ju jap edhe fizikisht si dëshmi që çdo ditë Podujeva merr rezultatet për 15 deri në 25 raste, nganjëherë ndodh edhe më shumë, pra jo më pak se 15 teste. Mandej çështja e oksigjenit, oksigjenoterapia është një terapi e cila iu ofrohet pacientëve të cilët kanë sëmundje apo shenja të sëmundjes të përkeqësuar dhe niveli parësor shëndetësor mbetet që t'i përkrahë për një periudhë të caktuar por jo t'i mbështes 24 orë, pra në momentin që pacienti ka nevojë për mbështetje me oksigjenoterapi në periudhë afatgjatë absolutisht nuk mbetet që trajtimi i tij të bëhet në nivelin parësor shëndetësor apo në nivelin shtëpiak apo të banimit, por mbetet që ai pacientë të shtrihet në klinikë, kurse sa i përket furnizimit absolutisht nuk kemi çfarë të themi diçka kur të gjithë kemi njohuri se oksigjeni është çështje që importohet prej shteteve fqinje, pastaj vështirësitë për sigurimin e oksigjenit ekzistojnë prej nivelit qendrorë deri në nivelin lokal, por ne me mundësitë tona në nivelin lokal jemi munduar qysh prej periudhës së mëhershme që të bëjmë sigurimin e aparaturave që quhen oksigjen konzentror të cilat janë aparate të cilat vendosen në rrymë dhe prodhojnë oksigjenin e që kemi disa të tilla dhe janë në dijeni për këtë kolegët tanë që janë në marrëdhënie pune në QKMF-Podujevë.

Sa i përket furnizimit me dezinfektues, vetëm para dy javëve jemi furnizuar me 1000 copë dezinfektues por shfrytëzimi i tyre mëno se duhet të jetë brenda institucionit dhe brenda hapësirave të tij, ndërsa lidhur me pakot ushqimore dhe higjienike ne në vazhdimësi duke i falënderuar edhe donatorët por edhe kohëve të fundit kemi bërë kontrata me vlera të ulëta kemi mbështetë familjet që janë në vetë izolim. Sa i përket kontributit që do të mund ta jep secili në Shtabin Emergjent, dëshiroj t'ju njoftoj se ky Shtab është i përbërë prej profesionistëve dhe kontura apo modeli i strukturës së tij është prej Qeverisë së Republikës së Kosovës, do të thotë se nuk e kemi ngritë ne vetëm ashtu që të mos e fusim dikë, përndryshe nëse ka ndonjë Shtab i cili ka ruajtur konturat ka të përfshirë edhe nga opozita apo diçka të ngjashme të na tregoj këtu (e them këtë në kuptimin e praktikës), ngase sa për njoftim në kuadër të Shtabeve janë drejtorët e Drejtorive të fushave përkatëse përfshirë edhe të QKMF-së, është epidemiologia, drejtori i DSHPMSh, përfaqësuesi i Bashkësisë Islame,

përfaqësuesi i Policisë, përfaqësuesi i OJQ-ve dhe nuk e di që ka përfaqësues tjerë, prandaj në kuptimin më të mirë po e them që urdhëroni gjejeni ndokush ndonjë model tjetër apo ndonjë anashkalim që kemi bërë ne, absolutisht që edhe për neve do të ishte i mirëseardhur kontributi i gjithsecilit, madje secili nga ju që vlerësoni se mund të kontribuoni diçka absolutisht që derën hapur e keni. Sa i përket çështjes së ngritur siç u potencua se ka persona të diagnostifikuar pozitiv me covid-19 dhe të cilët bredhin nëpër qytet të lirshëm, unë mendoj që është përgjegjësi e inspektoratit komunal dhe policisë, dhe absolutisht sikur unë që jam drejtor i DSHMS-së si institucion i vetëm që komunikoj me qendrën operative emergjente dhe marrim informata të përditësuara me emra mbiemra dhe numra të kontaktit të qytetarëve që janë pozitiv me covid-19 por edhe atyre që janë të testuar dhe që rezultojnë negativ, dhe Policia e Kosovës në mënyrë automatike e ka të njëjtën informatë. Rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës janë që për çdo ditë sa herë që marrim informata është që familjet e atyre që rezultojnë pozitiv të përcillen, të mbahen në izolim, të komunikohet me ato familje, por asesi të lëvizin brenda periudhës që është rekomanduar.

Nuk po dëshiroj t'i jap tjetër konotacion kësaj teme por megjithatë mendoj se është shqetësuese dhe ekskluzivisht ata që merren me mjekësi dhe ata që janë në dijeni se çka janë sëmundjet epidemiologjike / ngjitëse, ata që janë në dijeni rreth Ligjit për kontrollin dhe parandalimin e sëmundjeve ngjitëse e dinë më së miri se për çfarë bëhet fjalë, andaj lusë të gjithë qytetarët që t'i marrin si shumë serioze dhe t'iu përmbahen rekomandimeve. Nëse ne si profesionistë shëndetësorë nuk e bartim barrën dhe ta përcjellim rekomandimin dhe ta zbatojmë me përpikëri atëherë nga të tjerët çfarë mund të presim.

Ishte edhe një pyetje rreth familjeve, unë kur e thash që deri tani kemi 112 raste aktive, do të thotë se po flasim për 112 familje dhe të gjitha janë të izoluara, ndërsa sa i përket asaj se a duhet të testohen të gjithë ashtu siç ka qenë në fillim të pandemisë, rekomandimet e fundit të IKSHPK por edhe të OBSH-së nuk e cekun që secili qytetarë kontakti apo kontakt i kontaktit duhet të testohet për ta zbuluar burimin e infeksionit sepse tani veç dihet burimi i infeksionit dhe tani testimi për covid-19 bëhet vetëm tek pacientët që kanë shenja të sëmundjes, mandej kemi edhe rekomandimin tjetër të fundit i cili thotë që qytetarët të cilët kanë ankesa të sëmundjes, pa testimin për covid-19 me rekomandimin e mjekut familjarë që e ka vizituar atë person, thuhet se ai vetë shkon vetë izolim për dy javë dhe absolutisht nën mbikëqyrje përmes kontaktit me telefon e nëse ka nevojë edhe për shërbimin shëndetësorë, t'i ofrohet, pra mundet që pa testim fare të mbetet për dy javë në vetë izolim dhe ta përcjellë dinamikën e sëmundjes, ndërsa pacientit që është pozitiv me covid-19 ka obligim ligjor të vetë izolohet dhe të mos ka kontakt me familjarët tjerë të familjes, mirëpo edhe familjarët duhet të mbajnë vetë izolimin për dy javë.

Edhe një çështje, informatat e fundit që i kemi të përditësuara për personalin shëndetësorë se a ka po jo masa mbrojtëse parandaluese duke përfshirë maskat, dorezat, dezinfektuesit etj, e potencia se kemi informata dhe ato të përditësuara sipas regjistrimeve dhe duke i falënderuar investimeve të Komunës, prej listës esenciale të Ministrisë së Shëndetësisë por edhe prej donatorëve, pra jemi mirë me masa mbrojtëse parandaluese.

z.Vendenis Lahu, theksoi, vetëm desha të bëjë një përmirësim drejtorit të DSHMS-së i cili besoj se bëri një gabim të paqëllimshëm, pra nuk duhet të jenë të izoluar anëtarët e familjes në kuptimin parësorë të fjalës sepse sëmundjet infektive nuk janë sëmundje kongjinitale, duhet të jenë të infektuar anëtarët e familjes të cilët banojnë në një shtëpi ose që kanë kontakt direkt me anëtarin e familjes, dhe anëtarët që nuk janë të familjes por që po ashtu banojnë në të njëjtën shtëpi ose banesë, por jo anëtarët me lidhje familjare gjenetike sepse dikush mund të jetoj në Amerikë, dikush në Gjermani etj, e që besoj se kjo do ishte e palogjikshme. Pra besoj se kjo ishte vetëm një gabim teknik

sepse është më e kuptueshme të thuhet se anëtarët e familjes sepse tek ne presupozohet se jetojnë bashkërisht tërë kohën.

Pra vetëm deshta të bëjë këtë sqarim sepse i duhet ndokujt në rast të ndonjë keqkuptimi të mundshëm.

z.Zaim Thaqi, drejtor i DSHMS, sqarim shtesë, unë nuk jam në dijeni për statusin e askujt që ka në familje. Prindi juaj (i drejtohet parafolësit) në këtë rast është diagnostifikuar pozitiv me covid-19, por që ai me madhështinë e tij është vet izoluar dhe përmes rrjeteve sociale e ka bërë publike këtë çështje, kurse ne kemi edhe të dhëna zyrtare për personat që janë pozitiv me covid-19, për secilin, mirëpo seriozisht nuk e di statusin që ju keni në familje, a jetoni bashkë apo jeni të ndarë, prandaj për këtë unë nuk deshta të lëshohem në detaje por që në mënyrë indirekte e dhash një përgjigje.

Pra sikur ju të jetoni bashkërisht, sinjerisht nuk do të dëshiroja që ju sot të jeni prezent këtu.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa i përket rastit që prindi i këshilltarit parafolës ka dalë pozitiv me covid-19, unë dje kam kontaktuar përmes telefonit me z.Vendenis Lahu i cili më ka njoftuar se ka bërë testin dhe ka dal negativ, çështje për të cilën edhe nuk ka marrë pjesë në mbledhjen e KPF-së.

z.Vendenis Lahu, theksoi, është e kuptueshme që asnjëri prej nesh nuk duhet të jetë prezent këtu në rast se potencialisht mund të jetë pozitiv ose në rast se është person kontaktues apo i dyshuar që mund të jetë i infektuar me covid-19. Në fakt si profesionist shëndetësorë që jemi ne disa këtu, për çdo ditë kemi kontakte me persona të sëmurë, mirëpo natyrisht kemi masat mbrojtëse.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, përkulemi para gjithë stafit shëndetësor të cilët po bëjnë të pamundurën me covid-19. Duhet të mbetemi të përkushtuar maksimalisht, sidomos mekanizmat bartës qoftë të nivelit lokal qoftë qendrorë që jo vetëm t'i përfillim rekomandimet e dhëna nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare sa i përket luftimit të coronavirusit deri sa ta zhdukim tërësisht, andaj duke ju falënderuar të gjithëve për kontributin e dhënë, e konstatoj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

4. Propozimi i Drejtorisë së Arsimit, për ngritjen e Komisionit për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet edukativo arsimore në Komunën e Podujevës

Kryesuesi Kuvendit, theksoi, siç edhe jeni të njoftuar rreth kësaj pike e cila hyri si pikë e veçantë e rendit të ditës nga mbledhja e KPF-së dhe ka të bëjë me ngritjen e një komisioni siç edhe keni mund ta vëreni në propozimin e Drejtorisë së Arsimit drejtori i të cilës pak më parë kërkoj falje që për shkaqe se ka një aheng familjarë duhet të shkoi në shtëpi dhe njëkohësisht kërkoj leje që fjalën hyrëse ta jep njëri prej drejtorëve të Komunës.

z.Zaim Thaqi, drejtor i DSHMS, në emër të drejtorit të Drejtorisë së Arsimit i cili nuk ishte prezent në sallë, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, megjithëse drejtori i Drejtorisë së Arsimit më kërkoj që ta prezantoj këtë propozim për ngritjen e Komisionit për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet edukativo arsimore në Komunën e Podujevës.

Drejtoria e Arsimit bazuar në nenin 5.1 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për detyrat, përgjegjësitë dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit në institucionet edukative arsimore dhe aftësuese para universitare nr.15/2019 të datës 19.07.2019, Drejtoria e Arsimit propozon; që Kuvendi i Komunës në Podujevë ta votoj Komisionin e përzgjedhjes së drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet edukativo arsimore të Komunës së Podujevës, në këtë përbërje;

1-Selman Gashi, zyrtar për çështje pedagogjike në drejtorinë e Arsimit, me kualifikim master i pedagogjisë,

2-Luljeta Shala, përfaqësues i Këshillit të prindërve, me kualifikim profesorë e Edukatës Fizike, dhe

3- një anëtar/e nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe teknologjisë, si dhe çështje tjera të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ përkatës.

Komisioni do t'i zhvilloj procedurat për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të institucioneve arsimore për të gjitha konkurset deri më 31 gusht, dhe si argument dëshiroj t'ju njoftoj se konkursi për drejtor dhe zëvendës drejtor është i shpëlluar 22 korrik 2020 dhe ky komision i propozuar është profesional.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, si kërkesë të drejtorit të Drejtorisë së Arsimit dhe në mbledhjen e KPF-së e kemi mbështetë që të hynë në rend të ditës për shkak të afatit kohorë që muaji gusht do të jetë pushim për Kuvendin. Në bazë të Udhëzimit Administrativ përkatës ky vendim duhet të votohet në Kuvend dhe tani nuk mund t'i drejtohem drejtorit parafolës i cili e paraqiti fjalën hyrëse mirëpo drejtorit përkatës të Drejtorisë së Arsimit i cili ka bërë kërkesë i kam treguar në mbledhjen e KPF-së që përfaqësuesi i arsimit i propozuar nga Këshilli i prindërve për Kuvend duhet të sillet procesverbali i mbledhjes së prindërve të cilët e propozojnë përfaqësuesin e tyre për këtë komision, kështu që nëse ju ka lënë procesverbalin është mirë ta cekni se në cilën datë është mbajtur takimi i këshillit të prindërve dhe si është propozuar, nëse jo anëtar/i ja që propozohet aty për aty është i papranueshëm si dhe është jo ligjor, administrativ dhe procedural. E them këtë sepse drejtori i DKA-së premtoi se do ta sjellë procesverbalin në fjalë dhe që siç tha i kam emrat të gatshëm, kurse unë i kam kontaktuar një numër të anëtarëve të Këshillit të prindërve të Komunës së Podujevës dhe asnjë prej të kontaktuarve dhe asnjë nuk është i njoftuar dhe nuk është thirr nga kryetari i Këshillit të prindërve për të mbajtur një takim për të propozuar anëtarin e tyre, kështu që neve na ka vënë skeptik sa i përket votimit apo jo të këtij anëtar.

Me shumicë të votave mund të kaloj ky propozim sepse jemi në dijeni për përbërjen e Kuvendit mirëpo në këtë formë nuk mund të votoj unë personalisht dhe nuk e besoj se do të voton as Grupi i këshilltarëve të PDK-së për arsye se jemi marrë vesh për diçka të tillë, e kemi futë me vonesë në rend të ditës dhe e kemi mbështetë si pikë shtesë.

Çështja tjetër, në bazë të Memorandumit zyrtar të nënshkruar nga Kryetari i Komunës së Podujevës tani Ministër z.Agim Veliu, është që në çdo komision, për mbikëqyrje të transparencës duhet të merr pjesë përfaqësuesi i OJQ-ve, pra është diçka që është nënshkruar nga vetë Komuna, andaj është dashtë OJQ-të ta mbajnë mbledhjen dhe ta zgjedhin një përfaqësues në këtë komision, pastaj Këshilli i prindërve është dashtë ta mbaj një mbledhje dhe ta caktojnë përfaqësuesin e tyre në këtë komision, kurse znj.Luljeta Shala që u propozua nuk është e propozuar nga Këshilli i prindërve i nderuari Kryesues i Kuvendit sepse ky këshill nuk ka mbajtur mbledhje, madje është një prej të punësuarave më të reja në sistemin arsimor të Podujevës, ndërsa z.Selman Gashi është zyrtar i Drejtorisë së Arsimit i caktuar nga vetë drejtori, nuk prej më të mirëve por është kompetencë e tij dhe nuk dëshiroj të hy në atë fushë.

Sa i përket përzgjedhjes, do t'i ketë problemet e njëjta për të cilat drejtori nuk po mund të jap përgjigje për pyetjet që ne si këshilltarë po shtrojmë vazhdimisht sepse ky komision do t'i përzgjedh drejtorët dhe zëvendës drejtorët, mirëpo drejtori ka caktuar zyrtarin përkatës dhe natyrisht se do të përballet me problemet e njëjta, kurse përfaqësuesi/ja e Këshillit të prindërve është propozuar nga vetë drejtori pa pasë një mbledhje të Këshillit të prindërve dhe si formë e tillë është e papranueshme për ne, të kuptohemi nuk ka të bëjë kjo me emrin, me gjithë respektin për të propozuarën, por nuk është mbajtur mbledhje e Këshillit të prindërve për at propozuar atë.

z.Hasan Ajeti, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së mbështesim propozimin e Drejtorisë së Arsimit, por gjithherë duke u mbështetur edhe në kriteret e përcaktuara nga Udhëzimi Administrativ përkatës i MASHT-it, në veçanti neni 5 pika 1.

z.Bajram Ajeti, theksoi, unë mendojnë se nuk është për ta neglizhuar dhe është tepër e rëndësishme kur kemi të bëjmë me rekrutimin për vendet e punës të cilat janë menaxhuese dhe të cilat kanë një fushë tepër të rëndësishme për jetën e qytetarëve dhe për brezat e rinjë siç janë drejtorët dhe zëvendësdrejtorët e shkollave. Se si ka shkuar deri më tani ne jemi në dijeni, si është bërë rekrutimi i tyre dhe çfarë vlerash janë përzgjedh edhe këtë e dimë, mirëpo tani meqë me Udhëzimin Administrativ nr.15/2019 janë përcaktuar disa kriteret që këto komisione duhet të kalojnë përmes asambleve komunale, dakord është bazë ligjore dhe duhet të respektohet, mirëpo mënyra se si sot është sjellë ky propozim dhe këta emra për komision është mënyrë arbitrare siç është rasti i zonjushës së propozuar, të cilën singërisht jua them se nuk e njoh fare, por të jetë e propozuar në emër të prindërve dhe të mos kemi një dëshmi se vërtetë Këshilli i prindërve e ka propozuar atë unë mendoj se kjo është e parregullt, dhe tani po më lindë dyshimi që drejtori i Drejtorisë së Arsimit për këtë arsye e lëshoi mbledhjen sepse ka premtuar se do ta prezantoj procesverbalin, kurse të propozuarin tjetër z.Selman Gashi, nuk po e njoh por megjithatë ne si opozitë t'jua themi të drejtën duam që të ketë një bazë konkurruese, procedura të ndershme dhe të nxirren sipas parimit të meritës më të mirët, sepse nga të mirët edhe kemi rezultate nesër pastaj.

Kështu që unë mendoj se ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e LVV-së, meqë nuk janë plotësuar kushtet për të na bindur neve se vërtetë janë kandidatët që meritojnë të jenë anëtar të komisionit për rekrutimin e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave, ne do ta lëshojmë mbledhjen, vendosni ju vet.

Kryesuesi i Kuvendit, sqarim, theksoi, për hir të vërtetës dhe transparencës drejtori i Drejtorisë së Arsimit edhe më herët ka kërkuar të lirohet ose të gjendet një formë e shtyrjes së takimit për shkak se ka dasëm, përkatësisht sot i martohet vëllau. Pra kjo është arsyeja që nuk munda të qëndroj ende në këtë mbledhje dhe nuk ka diçka të tillë çfarë u tha nga parafolësi kinse drejtori ka lëshuar këtë mbledhje për arsye siç u than.

Lëshohet mbledhja nga Grupi i këshilltarëve të LVV-së dhe nga këshilltari i (PSD-së) z.Blerim Maqastena.

Prezent në sallë mbeten 25 këshilltarë të Kuvendit.

z.Pajtim Hodolli, theksoi, pasi që vij nga fusha e arsimit dhe keni mund të shihni edhe përmes mediave unë kam qenë iniciatorë për at ndryshuar këtë Udhëzim Administrativ, madje jam edhe njëri prej iniciuesve të petitionit në Ministrinë e Arsimit për ta ndryshuar këtë Udhëzim Administrativ, gjë të cilën mund ta gjeni edhe në media, i kam edhe deklaratat publike që kam pasë për këtë çështje si dhe jam njëri prej hartuesve të këtij Udhëzimi Administrativ të ri, më habitë fakti qysh në komision nuk është një person i cili vie nga fusha e menaxhimit dhe me master e që krejt ndryshimit të këtij Udhëzimi është bërë shkak që drejtorët dhe zëvendësdrejtorët të mos pajisen me këtë pozitë pa pasur master dhe që të mos bien në kundërshtim pastaj me mësimdhënësit të cilët mund të jenë me master kurse drejtorët me bachelor.

E ceku edhe kolegu parafolës z.Rafet Llapshtica, nëse në komision nuk ka njerëz që vijnë nga kjo fushë ne do të votojmë kundër ose do ta lëshojmë mbledhjen.

z.Hasan Ajeti, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LVV-së e lëshoj mbledhjen sepse i kanë merak këto gjëra, por duhet të jemi të qartë sepse kemi të bëjmë me një Udhëzim Administrativ të nxjerrë nga MASHT, nuk është akt të cilin e nxjerrë pushteti lokal. Kriteret e përcaktuara janë jashtëzakonisht të

qarta, thuhet, dy anëtarë propozohen nga Drejtoria e Arsimit, mandej thuhet, të paktën anëtarët e propozuar duhet të kenë një kualifikim të barasvlershëm me kërkesat për kualifikim të kandidatëve për pozitat e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të shkollës. Pra askund nuk thuhet se pozicioni i tyre është obligativ të jetë ndonjë drejtor apo shef, do të thotë shihet vetëm pozicioni i kualifikimit, kurse i nderuar zotëri Hodolli, qysh bëhet plotësim ndryshimi i Udhëzimit Administrativ e keni kolegun aty afër z.Rafet Llapashtica i cili mund t'ju tregoj se si bëhet.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sa i përket legjislacionit në fuqi dhe Udhëzimeve Administrative, janë fuqiplotë dhe nuk na interesojnë neve si janë nxjerrë apo si është bërë plotësim ndryshimi i tyre.

Drejtori i DKA-së nuk është prezent këtu, mirëpo për mua personalisht dhe për Grupin e këshilltarëve të PDK-së na intereson vetëm procesverbali i mbledhjes së Këshillit të prindërve gjë të cilën ai vet e ka premtuar se do ta sjellë sot e që do të mund ta shihnim se si është propozuar anëtar i anëtarit / zyrtarit të DKA-së sepse është kompetencë ekskluzive e Drejtorisë, dhe një gjë të tillë do ta bëja edhe unë po të isha drejtor i DKA-së sepse i plotësoj në plotësisht kompetencat dhe përgjegjësitë ligjore të secilit ngase është pozicion dhe pozitë politike andaj edhe e respektoj anëtarin e propozuar nga DKA, e respektoj e dhe këtë të propozuarën si anëtare të Këshillit të prindërve, por mua më intereson procesverbali i mbledhjes së Këshillit të prindërve, apo i kryesisë së këtij Këshilli që ka propozuar anëtarin / përfaqësuesin e tyre, por nuk po dua që si përfaqësues i Këshillit të prindërve të hyjë propozimi i drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, kushdo qoftë ai drejtor.

Pra këtu është dilema, andaj i nderuar drejtor i DSHMS-së i cili e prezantove këtë në fjalën hyrëse, nëse ju ka lënë drejtori i DKA-së procesverbalin e Këshillit të prindërve, prezantoheni dhe do ta shqyrtojmë, nëse jo nuk do ta votojmë sepse jemi marrë vesh në KPF dhe e kam mbështet plotësisht që të hyjë pikë shtesë në rend të ditës, sikurse Grupi i LDK-së që është në pushtet. Nuk jemi subjekt i cili dëshiron të bëjë pengesa, por një takim i Këshillit të prindërve ka mund të bëhet dhe të kërkohet një procesverbal, qoftë e dhe jo formalisht ka mund të bëhet, e që unë i kam sugjeruar drejtorit që ta ketë si dokument sot në këtë mbledhje, madje i kam thënë thirrri kryesin e Këshillit dhe kërkojua një dokument, apo thuaje që nuk mund ta sjellë për shkaqe kohore apo ku ta dijë unë, e që do të ishte në rregull, ama jo në këtë formë sepse i kam treguar një gjë të tillë, kurse drejtori qëndroi në sallë deri në këtë pikë dhe shkoi, prandaj të gjithë mund ta votoni, unë jo dhe nuk dëshiroj të ndikoj tek asnjë këshilltarë se si voton sepse është qëndrim personal, por që i papranueshëm.

Deri sa nga Grupi i këshilltarëve të PDK-së po lëshohet mbledhja, dhe nuk pati të lajmëruar të tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit ftoj të konstatohet kuorumi, dhe e hedh në votim propozimin e Drejtorisë së Arsimit përfshirë edhe propozimet për anëtar/e të këtij komisioni.

Konstatohet se prezent në sallë janë 19 këshilltarë të Kuvendit.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 19 këshilltarë prezent në sallë, 17 vota janë për, asnjë votë kundër, dhe asnjë votë e përmbajtur, (të tjerët nuk morën pjesë në votim), miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit, për ngritjen e Komisionit përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore në Komunën e Podujevës, sipas konkursit me nr.prot.05/306 të shpallur më 22 korrik 2020, në këtë përbërje:

-Selman Gashi, zyrtar për çështje pedagogjike në Drejtorinë e Arsimit, kryesues

-Luljeta Shala, përfaqësuese e këshillit të prindërve, anëtare

-Përfaqësuesi i MASHT-it (tani Ministria e Arsimit dhe Shkencës), i/e cili/a caktohet nga po kjo Ministri, dhe

-Dy përfaqësues të Këshillit Drejtues (një prind dhe një mësimdhënës) në cilësinë e vëzhguesve, të cilët caktohen nga shkolla përkatëse.

5. Të Ndryshme

z.Bunjamin Hoti, paraqiti Përfundimin e Grupit punues ad-hoc i ngritur nga Kuvendi i Komunës për vlerësimin e mundësive ligjore dhe procedurale të plotësimit ndryshimit të Rregullores për orarin e punës së bizneseve, në përbërje prej 5 anëtarëve, 2 nga Ekzekutivi i Komunës dhe 3 nga Kuvendi i Komunës, theksoi, si grup punues pas takimit të mbajtur kemi ardh në këtë përfundim, si vijon;

- **Ekziston mundësi ligjore dhe procedurale e ndryshimit dhe plotësimit të Rregullores për orarin e punës së bizneseve** (sipas kërkesës së qytetarëve përmes peticioneve në fshatin Orllan)
- **Ndryshimin dhe plotësimin, përkatësisht draftimi i dokumentit duhet përgatitet nga Drejtoria përkatëse e Komunës ashtu siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi, dhe Rregulloren e MAPL-së 01/2017, në përputhje me nenet 5, 14 dhe 12**

Pra kjo ishte si përfundim i Grupit punues ad-hoc i cili është marrë me çështjen në fjalë.

z.Fatmir, Gashi, Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, falënderoj Grupin punues përkatës për punën që ka bërë dhe prezantimin e Përfundimit nga takimi që kanë pasur, të cilin më kanë dërguar edhe në formë të shkruar në e-mail.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit duke jua uruar Festën e Bajramit të gjithë këshilltarëve të Kuvendit të Komunës dhe gjithë qytetarëve të Komunës së Podujevës, si dhe duke iu uruar pushim të këndshëm këshilltarëve të Kuvendit (sepse muaji i gusht është muaj i pushimit sipas planit të punës së Kuvendit për vitin 2020) e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:20

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0040784/20

Podujevë,

30 korrik 2020

Kryesuesi i Kuvendit

Fatmir Gashi